



---

**REPUBLIKA E SHQIPERISË**  
**INSTITUCIONI I PREFEKTIT TE QARKUT SHKODER**



**RAPORT**

**PËR VEPRIMTARINË E KRYER NGA INSTITUCIONI GJATË VITIT 2023**

## RAPORT

### Për veprimtarinë e kryer nga Insitucioni i Prefektit të Qarkut gjatë vitit 2023

Qellimi i raportit është të ofrojë një përmbledhje të veprimtarisë së kryer për vitin 2020, përgjegjësi e drejtuesve të Institucionit, në përputhje me kerkesat e Ligjit 107/2016, datë 27.10.2016 “*Për Prefektin e Qarkut*”

**Hartuar nga:** Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara

**Adresa:** Rruga “28 Nëntori” Shkodër, tel/faks. 00355 2224 2705, e-mail: [prefekti.shkoder@mb.gov.al](mailto:prefekti.shkoder@mb.gov.al)

Shkoder, Janar 2024

Misioni i prefektit të qarkut është përmbushja e detyrimeve për të garantuar zbatimin e programit politik të Keshillit të Ministrave (Arritja e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike me rezultate konkrete në punësim dhe në përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve; Program që ka në bazë përpjekjet për rritjen e stabilitetit makroekonomik si një parakusht i rëndësishëm për një rritje të qëndrueshme ekonomike), në nivel qarku

# QARKU SHKODËR

1:135000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ÇESHTJEVE VENDORE



I.	Hyrje.....	6
II.	Përmbledhje .....	7
III.	Realizimi i detyrave dhe prioriteteve, në lidhje me programin e qeverisë.....	10
III.1.	Programimi dhe realizimi i të ardhurave.....	10
III.2.	Realizimi i Investimeve.....	12
IV.	Marrëdhëniet e Prefektit me Administratën e shtetit (Adm. Qendrore, Ministrinë, Institucionet qendrore në nivel vendor-Degët Territoriale).....	15
IV.1.	Institucionet në nivel vendor dhe veprimtaria e tyre.....	15
IV.2.	Problemet e rendit dhe të sigurisë, rekomandime për përmirësimin e punës në vazhdim.....	28
IV.4.	Grupet e punës ndërinstucionale (task-forcat).....	30
IV.4.1.	Task Forca Vendore antikanabis.....	31
IV.4.2.	Zbatimi i i masave, lidhur me çeshtjet e luftës kundër trafikimit të personave.....	33
IV.5.	Masat e marra për përballimin e situatave nga emergjencat.....	37
V.	Marrëdhëniet e Prefektit me njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë).....	40
V.1.	Kryerja e funksioneve të transferuara njësisive të vetëqeverisjes vendore.....	41
V.2.	Verifikimi i ligjshmërisë së akteve të organeve të vetëqeverisjes vendore dhe asistencë juridike për vendimmarrjen e këtyre akteve.....	48
V.3.	Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore për rritjen e performancës së të zgjedhurve vendor.....	50
VI.	Funksionet e deleguara, kryerja e veprimtarisë nga institucionet të cilave u janë deleguar funksionet nga institucionet qendrore.....	50
VI.1.	Shërbimet sociale .....	50
VI.2.	Zhvillimi i territorit.....	51
VI.3.	Zhvillimi i turizmit.....	53
VI.4.	Shërbimi i Gjëndjes Civile.....	57
VII.	Organizimi dhe veprimtaria e administratës së Prefektit.....	58
VII.1.	Organizimi.....	61
VII.2.	Urdhërat e nxjerra dhe zbatimi i tyre.....	61
VII.3.	Takimet e organizuara në funksion të kryerjes së veprimtarisë.....	61
VII.4.	Vlerësimi dhe trajtimi i ankesave të shtetasve.....	62
VII.5.	Veprimtaria e N/Prefektit.....	62
VIII.	Veprimtari të tjera të Prefektit.....	63
IX.	Objektivat për vitin 2023.....	64

## RAPORT

### Për veprimtarinë e kryer nga Institucioni i Prefektit të Qarkut gjatë vitit 2023

#### I. HYRJE

Raporti, i cili paraqet veprimtarinë dhe performancën e Institucionit është në pajtueshmëri me kërkesën për rritjen e profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë së administrates publike

Raporti pasqyron realizimin e detyrave dhe prioriteteve, në përputhje me programin qeverisës. Në raport pasqyrohet programimi dhe realizimi i të ardhurave dhe investimeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore (Këshilli i Qarkut dhe Bashkitë, brenda territorit të qarkut), si dhe nga institucionet qendrore në nivel vendor; Treguesit e punës; marrëdhëniet e Prefektit me administratën qendrore dhe rajonale, si dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë); Bashkëpunimi dhe koordinimi punës për realizimin e detyrave të ngarkuara; Verifikimi i ligjshmërisë së akteve normative të nxjerra nga organet e njësisive të vetëqeverisjes vendore; Problemet e rendit e sigurisë publike; Veprimtaria e kryer në parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit; Veprimtaria në çështjet e luftës kundër trafikimit të personave, si dhe rekomandimet për përmirësimin e punës në vazhdim; Kryerja e funksioneve të transferuara nga Institucionet qendrore njësisive të vetëqeverisjes vendore (Shërbimi Mbrojtjes nga Zjarri; Administrimi i pyjeve; Sistemi i ujitjes dhe kullimit; Menaxhimi i rrjetit të rrugëve rurale; Sistemi i arsimit parashkollor). Vëmendje e veçantë i kushtohet zhvillimit të turizmit; Përballimit të situatave të emergjencave civile dhe mbrojtjes civile; Kryerjes së funksioneve të deleguara; Po kështu në raport trajtohen problemet e ndjekjes dhe shqyrtimit të kerkesave dhe ankesave të ndryshme të qytetarëve; Urdhrat e nxjerra nga ana e Prefektit dhe zbatimi i tyre; Problemet e konstatuara gjatë analizave vjetore të veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor, etj.

Për hartimin e raportit përveç të dhënave të institucionit dhe të dhënave monitoruese, janë përdorur edhe të dhënat e institucioneve vendore, si dhe të dhënat e njësisive të vetëqeverisjes vendore

## II. PËRMBLEDHJE

- Kontributin më të madh në rritjen ekonomike e ka patur sezoni turistik, i cili edhe në qarkun Shkodër, ka qënë i suksesshëm, sukses që ka ardhur falë masave të qeverisë për kryerjen e investimeve publike dhe ofrimin e shërbimeve në destinacionet turistike, rritjen e investimeve (të cilat janë mbështetur në një sektor financiar të qendrueshëm dhe me likuiditet), por edhe si rezultat i rritjes së nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimit të punës në mes institucioneve vendore dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore, nga Prefekti i Qarkut, si dhe rritjes së nivelit të profesionalizmit dhe përgjegjshmërisë së administrates publike.

- Nga ana e Prefektit ne permbushje te misionit dhe ushtrimit te pergjegjesive është bashkëpunuar dhe koordinuar veprimtaria e institucioneve vendore dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e detyrimeve ligjore, sipas kompetencave dhe fushave të përgjegjësisë;

- Janë organizuar takime të vazhdueshme periodike dhe sipas rasteve, për analizimin e veprimtarisë, problemeve të hasura, të cilat kanë ndikuar në kryerjen e detyrave të ngarkuara, duke përcaktuar dhe marrjen e masave, për zgjidhjen e tyre (Menaxhimin e mbetjeve, Funkcionimin e tregjeve; Dëmtimet në pyje, etj)

- Janë organizuar takime, lidhur me analizimin dhe ecurinë e zbatimit të detyrave, siç është rasti i takimeve të vazhdueshme për sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e publikut në parandalimin dhe eliminimin e kultivimit të bimëve narkotike; Në Çështjet e luftës kundër trafikimit të personave; Për çështjet e rendit dhe sigurisë publike; Për mbarëvajtjen e sezonit turistik; Situatën emergjente të krijuar nga reshjet, përmbytjet, zjarret; Për fillimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor në sistemin arsimor parauniversitar, përfshi sigurimin e ngrohjes në shkolla; Mbi sigurinë në shkolla; etj.

- Janë organizuar, sipas njësite të vetëqeverisjes vendore takime me drejtues të ketyre njësiteve dhe të institucioneve vendore, për zbatimin e detyrave të përbashkëta

- Janë organizuar takime në institucionet vendore (Degët Territoriale), lidhur veprimtarinë e ushtruar, gjatë periudhave të ndryshme të vitit, duke u përqendruar tek institucionet e ofrimit të shërbimeve dhe inspektoratet shtetërore

- *Të ardhurat e realizuara në nivel qarku*

- Janë realizuar të ardhura nga tatimet, përfshirë të ardhurat nga kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore, me një vlerë prej 7,767,723 mijë lekë, ose 99 % e të ardhurave të programuara, me një mosrealizim prej 83,303 mijë lekë (mosrealizim i cili ka ardhur nga mos realizimi i të ardhurave nga kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore dhe taksa nacionale. Megjithëse të ardhurat e programuara nuk janë realizuar, krahasuar me vitin e kaluar (2022) realizimi i të ardhurave ka pësuar rritje me 1,001,973 mijë lekë, por edhe me krahasuar me vitin 2020 dhe me vitin 2019 me 772,843 mijë lekë (gjatë vitit 2019 janë realizur të ardhura me vlerë 5,992,157 mijë lekë). Për vitin 2023 DRSSH Shkodër ka realizuar detyrat e ngarkuara për mbledhjen e të ardhurave nga kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi me tejkallim të planit vjetor, realizuar në masën 119.3%, kontributet vullnetare me tejkallim të planit vjetor në masën 105% si dhe ka ndjekur në vazhdimësi kontributet e subjekteve shtetërore e private, mbledhja e të ardhurave nga të cilat është përgjegjësi e Drejtorisë së Tatim Taksave.

-

- Nga ana e Prefektit të qarkut, në cilësinë edhe të drejtuesit të KRZHT;

Është ngritur Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit, mbështetur në pikën 1 të nenit 20 të Ligjit Nr. 93/2015, datë 27.07.2015 “Për Turizmin” dhe Udhëzimin Nr. 8502 datë 24.10.2016 të Ministrisë të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit” (pika 2.1, 2.2, 2.3 e kap. II), komiteti i cili drejtohet nga Prefekti dhe ka në përbërje përfaqësuesit e institucioneve dhe njësive të vetëqeverisjes vendore. Është hartuar e miratuar plani i veprimit në nivel qarku “Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2023” duke u mbështetur në planet e Institucioneve qendrore në nivel vendor dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, përgjegjëse për zhvillimin e veprimtarisë turistike.

Janë organizuar takimet e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, në të cilën janë ftuar edhe të gjithë drejtuesit e Institucioneve dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, takime në të cilat është analizuar e vlerësuar veprimtaria e Komitetit dhe Institucioneve dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, masat e marra, problemet e hasura.

Është bërë hapja zyrtare e sezonit turistik (Në bashkinë Shkodër, në plazh Velipojë, pikën turistike të Thethit e Shirokës, si dhe në Nj. A. për promovimin e vlerave dhe resurseve, kryesisht në fushën e agroturizmit, të cilat ndikojnë në zhvillimin social ekonomik të këtyre njësive; Në bashkinë Malësi e Madhe në pikën turistike Razëm e Vermosh; Në bashkinë Vau i Dejës në Nj. A Vau i Dejës e Temal, në promovimin e vlerave në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit; Në bashkinë Pukë)

- Në zbatim të planit kombëtar kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit nga ana e Task Forcës Vendore Antikanabis është bashkëpunuar dhe koordinuar veprimtaria e institucioneve vendore, njësive të vetëqeverisjes vendore dhe strukturave të tjera pjesë përbërëse e Task Forcës, në mënyrë të veçantë e strukturave të policisë së shtetit, për parandalimin e kultivimit dhe goditjen e kësaj veprimtarie kriminale.

- Për çështjet e luftës kundër trafikimit të personave është rritur niveli i bashkëpunimit të Komitetit Rajonal, strukturave të policisë së shtetit, njësive të vetëqeverisjes vendore, institucioneve qendrore në nivel vendor, shoqatave dhe individëve të ndryshëm, si dhe koordinimit të veprimtarisë nga Institucioni i Prefektit, në mënyrë të veçantë sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve, ku janë zhvilluar aktivitete, me qëllim parandalimin e kësaj veprimtarie kriminale.

- Nga ana e Prefektit në përmbushje të misionit, ushtrimit të përgjegjesive dhe veprimtarisë janë nxjerre 120 Urdhra; Janë zhvilluar mbi 60 takime si me grupin këshillues pranë Prefektit, ashtu edhe me drejtues të institucioneve qendrore në nivel vendor, të njësive të vetëqeverisjes vendore, etj., për zbatimin e detyrimeve ligjore të parashikuara në planin e veprimit antikanabis, për çështjet e luftës kundër trafikimit të personave, problemet e emergjencave civile, menaxhimin e mbetjeve, mbarëvajtjen e sezonit turistik, ligjshmerinë e akteve të nxjerra nga njësitet e vetëqeverisjes vendore, etj.; Janë shqyrtuar dhe vlerësuar, duke u kthyer përgjigje, 64 kërkesa dhe ankesa të ndryshme të qytetarëve, subjekteve publike e private.

- Viti 2023, Konsiderohet si viti me I sukseseshëm në parandalimin dhe shuarjen e zjarrev në krahasim me vitet e tjera dhe me Prefekturat e tjera, pasi goditja parandaluese e



strukturave të DVP ka qene efikase, ndergjegjesimi ka qene efikas dhe nderhyrja e menjehershem e strukturave reaguese qe nga niveli local ka qe ne momentin e shfaqes se zjarrit ka qene efikas, pasi nuk eshte kerkuar asnje ndihme apo mbeshtetje nga strukturat qendrore apo futulurimet nga ajri Kriminaliteti gjatë vitit krahasuar me vitin e kaluar ka pësuar ulje me 65 vepra, ose mbi 3 %. Ndërsa shkalla e zbulueshmërisë është afërsisht në të njëjtin nivel

- Pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, në sekretari-arkivin gjatë vitit 2023, nga 6 njësi të qeverisjes vendore- 5 bashki dhe Këshilli i Qarkut Shkodër si njësi e dytë e qeverisjes vendore-, janë depozituar gjithsej **346** akte, nga të cilat **321** akte normative kanë qenë në përputhshmëri ligjore referuar funksioneve vendore, ndërsa për **25** akte nuk është lejuar procedim i mëtejshëm sipas argumentave ligjor. Të gjitha aktet janë shqyrtuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore specifike referuar Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175, datë 9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksi I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”,

### **Rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë**

- Miratimi i akteve nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e njësive të vetëqeverisjes vendore
- Përcaktimi dhe miratimi i venddepozitimit të mbetjeve inerte, për të gjitha bashkitë
- Rishikimi i Rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit” (miratuar me VKM Nr. 171, me ndryshime), për;
  - Garantimin e sigurisë së pushuesve në stacionet e plazhit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratave (për të shpëtuar jetën në ujë dhe për të dhënë ndihmën e pare mjekësore) dhe shmangien e formalizmave (rishikimin e neni 5/8/b të rregullores), duke i ngarkuar kontraktimin e shërbimit e vrojtimit për të gjithë territorin e plazhit, autoritetit shtetëror (Institucioni qendror/njësish të vetëqeverisjes vendore) kundrejt një tarife, të qiramarrësit të hapësirës publike për ushtrimin e aktivitetit të stacionit të plazhit (sipas sip. së çdo stacioni)
    - Monitorimi dhe ndërhyrjet, për paligjshmërinë e veprimeve të kryera nga persona/subjekte, në zonën bregdetare, të përfundojnë përpara fillimit të sezonit turistik veror 2024, kjo për të shmangur ndërhyrjet gjatë sezonit me ndikim negativ në zhvillimin e turizmit
    - Ofrimi i shërbimit të transportit publik drejt dhe në pikën turistike Theth (Licensimin e subjekteve, nënshkrimin e marrëveshjeve për kryerjen e shërbimit, caktimi i stacioneve të nisje-mbërritjeve dhe kontaktet e tyre në vende të dukshme me tabela fizike dhe aksesueshëm në internet-faqet Eëb të Bashkisë Shkodër; AdZM Shkodër; Si dhe pranë zyrave të informacionit turistik etj.);
    - Bashkëpunimi njësi e vetëqeverisjes vendore me institucionet qendrore në marrjen e masave për zgjidhjen e problemit të pronësisë mbi pasurinë në zonat turistike, në menyrë të veçantë në zonën turistike Theth, mbi ndikim në zhvillimin e turizmit dhe jo vetëm
    - Rritja e bashkëpunimit dhe e koordinimit të veprimeve mes të gjithë aktorëve,

marrëdhëniet direkte me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet qendrore në nivel vendor (Degët Territoriale), duke krijuar struktura (grupe ndërinstitucionale) të veçanta bashkëpunimi, për shërbimet e ndërsjella të policisë vendore, policisë bashkiake dhe institucioneve qendrore në nivel vendor (duke analizuar periodikisht nivelin e bashkëpunimit dhe rezultatet e arritura) për kontrollin efektiv të territorit, me qëllim parandalimin e ndërtimeve pa leje; Krimeve mjedisore (ndotja e mjedisit nga mbetjet, prerja e paligjëshme dhe dëmtimi i pyjeve, etj); Kultivimit të bimëve narkotike e përdorimit të lëndëve narkotike jo vetëm në ambientet e shkollave dhe universitetit, por edhe jashtë këtyre ambienteve nga nxënësit dhe studentët, si kontingjenti më i rishikuar; Ndotjes akustike, me vemendje të shtuar ndotjes nga zhurma e automjeteve (ndërrhyrjet dhe modifikimi i mjeteve, përfshi edhe motorët, të cilët gjenerojnë zhurma tej normave të lejuara dhe të bezdisshme për qytetarët); Aksidenteve rrugore e disiplinimin e trafikut rrugor, nëpërmjet shërbimeve të përbashkëta të struktura të policisë me ato të institucioneve përgjegjëse e të njësisve të vetëqeverisjes vendore (vendosjen e sinjalistikës rrugore dhe përcaktimin e vendqendrimeve të mjeteve të transportit të udhëtarëve)

### III. REALIZIMI I DETYRAVE DHE PRIORITETEVE, NË LIDHJE ME PROGRAMIN E QEVERISË

#### III.1. Programimi dhe realizimi i të ardhurave

##### III.1.a. Njësitë e vetëqeverisjes vendore

Janë realizuar të ardhura nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2023 me një vlerë prej 1,152,239 mijë lekë (nga 1,100,401 mijë lekë të realizuara gjatë vitit të kaluar 2022) ose 87 % e të ardhurave të programuara, me një mosrealizim prej 176,489 mijë lekë.

Programimi dhe realizimi i të ardhurave, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, për vitin 2023 dhe 2022, paraqitet:

*Në mijë lekë*

Nr.	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore	Të ardhurat gjithësej				
		Viti 2023			Viti 2022	
		Program	Fakt	%	Fakt	%
1	Keshilli i Qarkut	2,090	1,772	85	2,020	96.6
2	Bashkia M. Madhe	149,296	109,824	74	77,888	73.1
3	Bashkia Shkoder	932,387	874,045	94	871,536	93.5
4	Bashkia Vau i Dejes	170,018	97,304	57	95,027	49.4
5	Bashkia Puke	46,382	49,190	101	33,801	77.2
6	Bashkia Fushe-Arrez	28,555	22,569	79	20,129	70.5
	<b>Totali</b>	<b>1,328,728</b>	<b>1,152,239</b>	<b>87</b>	<b>1,100,401</b>	<b>84.3</b>

Gjatë vitit me gjithë mosrealizimin e të ardhurave të programuara, krahasuar jo vetëm me vitin e kaluar por edhe me vitin 2021 realizimi i të ardhurave ka pësuar rritje respektivisht me 51,838 mijë lekë nga viti 2022.

### III.1.b.Të ardhura nga tatimet dhe kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore (Drejtoria Rajonale Tatimore)

Janë realizuar të ardhura nga tatimet, përfshirë të ardhurat nga kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore, me një vlerë prej 7,767,723 mijë lekë ose 99% me një mosrealizim prej 83,303 mijë lekë (mosrealizim i cili ka ardhur nga mos realizimi i të ardhurave nga kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore dhe i taksave nacionale). Krahasuar me vitin e kaluar (2022) realizimi i të ardhurave ka pësuar rritje me 1,001,973 mijë lekë.

Programimi dhe realizimi i të ardhurave, sipas zërave për vitin 2023 dhe 2022 paraqitet:

*Në mijë lekë*

Nr	Lloji i të ardhurave	Viti 2023			2022	
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt
1	Tatim mbi vlerën e shtuar	802,943	858,106	69	650,000	655,358
2	Ttim-fitimi	719,664	673,850	68	580,000	611,380
3	T/ardh. Pers.+ dënime admin	1,041,650	1,058,408	102	919,999	918,840
4	Taksa nacionale	40,457	32,335	80	55,001	32,530
	<b>Totali Tatime</b>	<b>2,604,714</b>	<b>2,622,699</b>	<b>101</b>	<b>2,205,000</b>	<b>2,218,108</b>
5	Kontribut sig.shoq. e shënd.	5,246,312	5,145,024	98	4,670,000	4,547,6412
	<b>Gjithsej</b>	<b>7,851,026</b>	<b>7,767,723</b>	<b>99</b>	<b>6,875,000</b>	<b>6,765,750</b>

Janë arkëtuar të ardhura, kontribut për sigurime shoqërore e shëndetësore nga të vetëpunësuarit në bujqësi dhe sigurim vullnetar me vlerë 260,706 mijë lekë nga 226,960 mijë lekë në vitin 2022 (nga të vetëpunësuarit në bujqësi 230,195 mije leke nga 205,286 mijë lekë në vitin 2022 dhe sig. vullnetar 30,511 mijë lekë nga 21,674 mijë lekë në vitin 2022)

Për vitin 2023 DRSSh Shkodër ka realizuar detyrat e ngarkuara për mbledhjen e të ardhurave nga kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi me tejkalim të planit vjetor, realizuar në masën 119.3%, kontributet vullnetare me tejkalim të planit vjetor në masën 105% si dhe ka ndjekur në vazhdimësi kontributet e subjekteve shtetërore e private.

### III.2. Realizimi i Investimeve

#### III.2.a. Investimet, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore

Janë kryer shpenzime për investime gjatë vitit 2023 nga njësitë e vetëqeverisjes vendore

(me të ardhurat e veta) me vlerë 852,702 mijë lekë, nga 1,159,219 mijë lekë të programuara, ose 74 % e shpenzimeve të programuara (janë kryer shpenzime për investime për vitin 2022 me vlerë 795,579 mije leke.

*Në mijë lekë*

Nr.	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore	Fakt 2023	Fakt 2022
1	Këshilli i Qarkut	58,054	15,627
2	Bashkia Shkodër	322,436	344,945
3	Bashkia Malësi e Madhe	222,158	291,482
4	Bashkia Vau i Dejës	222,005	69,910
5	Bashkia Pukë	13,986	55,192
6	Bashkia Fushë Arëz	14,063	18,423
	<b>Shuma</b>	<b>852,702</b>	<b>795,579</b>

### III.2.b. Investime me fondet e qeverisë nga FShZh

Në bashkitë e qarkut, janë kryer investime nepermjet FShZh ku ndër projektet prioritare të QSH mund të përmendim:

Në Bashkinë Shkodër, “Rigjenerimi I stokut te banesave, bashkia Shkoder” me vlerë të kontratës 9,080 mijë lekë, “Nderhyrje Rigjeneruese ne blloqet e Banimit, Rikualifikimi I Fasadave te Banesave Kolektive dhe te 2 Godinave te Spitalit Rajonal Shkoder” me vlerë të kontratës 41,384 mijë lekë, “Permiresimi i sigurise dhe sinjalistikes rrugore, Rruga Theth-Nderlytaj, Bashkia Shkoder” me vlerë të kontratës 8,954 mijë lekë, “Nderhyrje rigjeneruese në blloqet e banimit: Rikualifikim Urban i Bllokut "Europa" dhe Bllokut Bulevardi "Zogu i I", Bashkia Shkodër” me vlerë 298,755 mijë lekë, “Permiresimi i shtresave rrugore ne disa segmente rrugore ne Bashkine Shkoder” me vlerë kontrate 149,638 mijë lekë. Ndër investimet qe vazhdojne edhe ne 2024 janë “Rehabilitimi i Shëngjin-Baks-Rrjoll (13 km)” i cili është në zbatim, financuar nga BERZH me vlerë kontrate 1,545,106 mijë lekë, për Bashkinë Shkodër janë: “Mbrojtja nga rreshkitjet dhe ndertimi i veprave te artit ne aksin rrugor Prekal-Kir, Bashkia Shkoder L=17.00km” me vlerë kontrate 200,805mijë lekë, “Nderhyrje per permiresimin e strukturave mbrojtese, veprave te artit ne aksin rrugor Kir - Lotaj - Nderlytaj, bashkia Shkoder” me vlerë kontrate 249,857 mijë lekë, “Nderhyrje ne hyrje te Shkodres dhe rikualifikimi I bregut perendimor te liqenit te Shkodres (Faza - I)” me vlerë 478,819 mijë lekë, “Rikonstruksioni dhe përmirësimi i rrugës Shirokë - Zogaj - Kufiri me Malin e Zi dhe sistemet e ujësjellësit dhe ujërave të zeza Shirokë - Zogaj, në qarkun e Shkodrës”(ritenderim) me vlerë 384,866 mijë lekë, “Ndertimi i molit te Shkodres” me vlerë 135,189 mijë lekë, “Mbeshtetje me furnizim materiale ndertimi me lende te pare, per realizimin e punimeve per projektin Materiale elektrike: "Ndricim rruget Velipoje", bashkia Shkoder me vlerë 31,642 mijë lekë dhe “Mbeshtetje me furnizim materiale ndertimi me lende te pare, per realizimin e punimeve per projektin Mobilim urban: "Ndricim rruget Velipoje", bashkia Shkoder” me vlerë 14,441 mijë lekë.

Në bashkinë Malësi e Madhe kanë përfunduar gjatë vitit 2023 projektet e “Mbështetjes me furnizim materiale ndërtimi, materiale elektrike dhe materiale KUZ për Malësi e Madhe” me vlerë

projekti 22,110 mijë lekë dhe janë në vazhdim për 2024 projektet “Rikualifikimi i Atraksionit Turistik Vermosh (rindertimi i ish-spitalit dhe kthimi në bujtine, rindertimi i shkollës, objekt shërbimesh, Strehe pjergullate dhe fusha e futbollit) me vlerë 79,400 mijë lekë dhe “Rikualifikimi i Atraksionit turistik të Lepushës” me vlerë 38,921 mijë lekë.

Në bashkinë Pukë ka përfunduar projekti “Ndërtimi i parkut të aventurave Pukë” me vlerë të projektit 69,818 mijë lekë.

### **III.2.c. Investime nga ARSH**

Nga ana e ARRSH me fondet e buxhetit janë kryer shpenzime për ndërhyrje, rehabilitim e përmirësime infrastrukturë rrugore dhe ndërhyrje emergjence me vlerë 9,718,296 mijë lekë (“Ndërtim rruga By Pass Perëndimor Loti 1” me vlerë 1,447,446,358 mijë lekë; “Ndërtim rruga By Pass Perëndimor Loti 2” me vlerë 454,574 mijë lekë; “Rikonstruksion i rruges Shkoder-Mes” me vlerë 428,108 mijë lekë, Ndërtim rruga Shkoder – Hani Hotit me vlerë 5,863,378 mijë lekë dhe aktualisht po zbatohet projekti “Ndërhyrje emergjence në km 5+500 dhe km 13+000, rehabilitimi i argjinaturave të përroit të thatë në Segmentin Dedaj-Bogë” me vlerë 77,343 mijë lekë etj.).

### **III.2.d. Investime për zhvillimin bujqësor (sistemi i ujitjes dhe kullimit) dhe mbrojtje nga përmbytjet (argjinatura)**

Janë kryer shpenzime për investime, rehabilitim e punime të domosdoshme, me fondet e buxhetit të financuara nga MBZHR, për përmirësimin e sistemit të ujitjes e kullimit dhe mbrojtjen nga gërryerjet e lumenjve me vlerë 170,758 mijë lekë (Investimet kryesore gjatë periudhës 2022 dhe kanë vazhduar në 2023 mund të përmendim, “Argjinatura e lumit Buna, Dajç-Shirgji” 42,846 mijë lekë; “Mbrojtje nga lumi Buna, Kisha e shirgjit, Shkoder” 43,802 mijë lekë; “Rehabilitimi i argjinaturës Darragjat, segmenti Pk. 26-33., L=170m” 13,287 mijë lekë) ndërsa ndër investimet kryesore që vazhdojnë edhe në vitin 2024 kemi: “Mbrojtje nga Lumi Drin në Juban” me vlerë 66,726 mijë lekë, “Rehabilitim I kanalit ujitës KU-3 Berdice, L=8.5km” me vlerë 3,825 mijë lekë, “Mbrojtje nga lumi Kir, ura e Bardhajve” me vlerë 2,426 mijë lekë, “Mbrojtje tërthore e argjinaturës Darragjat (punime emergjente) me vlerë 5,849 mijë lekë.

### **III.2.e. Investimet në proces realizimi**

Janë në proces realizimi investimet në njësitë e vetëqeverisjes vendore me fondet e veta (afro 852,702 mijë lekë në rritje nga viti I kaluar) ku mund të përmendim: Për Bashkinë Shkodër Rikonstruksione, Sistemim asfaltim, Rikualifikim Urban bllok pallatesh, Rikonstruksion objekte shkollash në vlerën 322,436 mijë lekë, Në bashkinë Malësi e Madhe me vlerë rreth 222,158 mijë lekë kryesisht në infrastrukturë rrugore (Sistemim asfaltim rrugësh, Përmirsim I aksesit dhe

vizibilitetit të Ujërave në fshatrat Lepushe dhe Vermosh, rrethim varrezash, mbjellje pemësh, sistemim fshatin Rrash) në arsim (Ndërtim I impjantit të ngrohjes në shkollat e mesme Koplík, Bajzë, Gruemirë), në ujësjellës (Ndërtim I Ujësjellësit Bajzë, Bashkia Malësi e Madhe) etj me fondet e AKUM kemi objektin "Ndërtim ujësjellësi Muriqan" nga Këshilli i Qarkut); Në bashkinë Vau i Dejës me vlerë mbi 222,005 mijë lekë (Infrastrukturë rrugore; Rikonstruksion shkolla, ndertim palestre; Rokonstruksion Qendra shëndetësore, etj.)

Janë në zbatim projekte për vitin 2023-2024 nepermjet FShZh, me një vlerë prej 118,041 mijë lekë në Qarkun Shkodër ku mund të përmendim:

- Rehabilitimi i rrugës Shëngjin – Baks-Rrjoll Road (13km)
- Ndertimi i Shtegut të bicikletave "Qafe Thore-Gropa e Portes, Theth"
- Ndërhyrje rigjeneruese në blloqet e banimit: Rikualifikim Urban i Bllokut "Europa" dhe Bllokut Bulevardi "Zogu i I", Bashkia Shkodër
- Permiresimi i shtresave rrugore në disa segmente rrugore në Bashkinë Shkoder
- Mbrojtja nga rreshkitjet dhe ndertimi i veprave të artit në aksin rrugor Prekal-Kir, Bashkia Shkoder L=17.00km
- Nderhyrje për permiresimin e strukturave mbrojtëse, veprave të artit në aksin rrugor Kir - Lotaj - Nderlytaj, bashkia Shkoder
- Nderhyrje në hyrje të Shkodres dhe rikualifikimi I bregut perendimor të liqenit të Shkodres (Faza - I)
- Rikonstruksioni dhe përmirësimi i rrugës Shirokë - Zogaj - Kufiri me Malin e Zi dhe sistemet e ujësjellësit dhe ujërave të zeza Shirokë - Zogaj, në qarkun e Shkodrës.
- Ndertimi i molit të Shkodres
- Mbeshtetje me furnizim materiale ndertimi me lende të pare, për realizimin e punimeve për projektin Materiale elektrike: "Ndricim rruget Velipoje", bashkia Shkoder
- Mbeshtetje me furnizim materiale ndertimi me lende të pare, për realizimin e punimeve për projektin Mobilim urban: "Ndricim rruget Velipoje", bashkia Shkoder
- Rikualifikimi i Atraksionit Turistik Vermosh (rindertimi i ish-spitalit dhe kthimi në bujtine, rindertimi i shkolles, objekt sherbimesh, Strehe pjergullate dhe fusha e futbollit)
- Rikualifikimi i Atraksionit Turistik të Lepushes

#### **IV. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT ME ADMINISTRATËN E SHTETIT (Administratën Qendrore, Ministrinë, Institucionet qendrore në nivel vendor)**

Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkoder në përmbushje të misionit dhe ushtrimit të përgjegjësiës ka shqyrtuar veprimtarinë e institucioneve qendrore në nivel vendor dhe ka bashkërenduar punën ndërmjet tyre, për realizimin e detyrave në përputhje me programin e qeverisë; Ka intensifikuar punën lidhur me bashkepunimin me institucionet qendrore në nivel

vendor, me njësitë e veteverisjes vendore, organizatat dhe shoqatat e ndryshme që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të Qarkut, nëpërmjet takimeve të shumta me drejtues të ministrive e Institucioneve të tjera qendrore, me qëllim zgjidhjen e problemeve që janë konstatuar nga institucionet në nivel Qarku.

Prefekti ka patur bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet qendrore, Degët Territoriale dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke koordinuar edhe veprimtaritë e tyre në nivel qarku, lidhur me menaxhimin e mbetjeve; Menaxhimin dhe zhvillimin e turizmit; Goditjen e informalitetit në ushtrimin e veprimtarisë së biznesit; Parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike dhe trafikimit të personave; Ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike; etj.

Gjatë vitit në ushtrimin e veprimtarisë së tij Institucioni ka patur një bashkëpunim shumë të mirë dhe është mbështetur nga Ministria e Brendshme (Drejtorinë e Politikave të Çështjeve Vendore), përfshirë drejtuesit kryesor, të cilët gjatë vitit kanë organizuar e zhvilluar takime për probleme të zhvillimit të turizmit e territorit; Çështjet e Luftës kundër trafikimit të personave; Zbatimin e planit kombëtar në luftën ndaj kultivimit të bimëve narkotike; etj. Me ministrinë e Brendshme është bashkëpunuar në zgjidhjen e të gjitha problemeve në nivel qarku edhe me institucionet e tjera qendrore, përfshirë problemet e mbrojtjes civile.

#### **IV.1. Institucionet qendrore në nivel vendor dhe veprimtaria e tyre**

##### **IV.1.1. Drejtoria Tatimore Rajonale dhe Drejtoria e Verifikimit dhe Koordinimit në Terren (Rajoni Verior)**

Drejtoria Rajonale Tatimore (Drejtoritë Funksionale, Sektorët, Zyrat apo punonjësit që zbatojnë një funksion të caktuar), strukturë e Administratës Tatimore Qendrore, që merret direkt me mbledhjen e detyrimeve tatimore, me ofrimin e shërbimeve dhe asistencës për tatimpaguesit, kontrollin e deklaratave dhe pagesave, kontrollin e tatimpaguesve, operon mbi bazën e manualeve procedurale të përgatitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ku përshkruhen me hollësi veprimet që këto njësi ndërmarrin sipas funksioneve të administrimit tatimor

Objektivat për vitin 2023 (Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare; Zbatimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor; Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore) në përgjithësi janë arritur

Janë realizuar të ardhura nga tatimet, përfshirë të ardhurat nga kontributet për sigurime shoqërore e shëndetësore, me një vlerë prej 7,767,723 mijë lekë, ose 99 % e të ardhurave të programuara, me një mosrealizim prej 83,303 mijë lekë (mosrealizim i cili ka ardhur nga mosrealizimi i të ardhurave nga kontributi për sigurime shoqërore e shëndetësore dhe taksa nacionale.

Megjithëse të ardhurat e programuara nuk janë realizuar, krahasuar me vitin e kaluar (2022) realizimi i të ardhurave ka pësuar rritje me 1,001,973 mijë lekë, por edhe me krahasuar me vitin 2020 dhe me vitin 2019 me 772,843 mijë lekë (gjatë vitit 2019 janë realizur të ardhura me vlerë 5,992,157 mijë lekë). Për vitin 2023 DRSSH Shkodër ka realizuar detyrat e ngarkuara për mbledhjen e të ardhurave nga kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi me tejkallim të planit vjetor, realizuar në masën 119.3%, kontributet vullnetare me tejkallim të planit vjetor në masën 105% si dhe ka ndjekur në vazhdimësi kontributet e subjekteve shtetërore e private, mbledhja e të ardhurave nga të cilat është përgjegjësi e Drejtorisë së Tatim Taksave.

Numri i të punësuarve në total gjatë vitit 2023 (tremujori III-të), është 30,534  
Sipas të dhënave të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve, për kontribuesit, numri i të punësuarve për vitin 2023 paraqitet:

Të dhëna mbi numrin e subjekteve dhe nr e punonjësve

Nr.	EMERTIMI	Sipas Tatimeve		SHKODRA		MALESIA E MADHE		PUKE	
		Subjekte	Punonjës	Subjekte	Punonjës	Subjekte	Punonjës	Subjekte	Punonjës
1	Aktiviteti Gjithsejt	6,488	30,534	5,665	25,529	513	3,063	310	1,942
2	Në sektorin Shtetëror	108	10,029	75	7082	14	1798	19	1149
2.1	Shtetëror buxhetor	97	9,468	70	7,039	12	1309	15	1,120
2.2	Shtetëror jobuxhetor	11	561	5	43	2	489	4	29
3	Në sektorin privat	6,380	20,505	5,590	18,447	499	1,265	291	793
3.1	Të rregjistruar si person fizik	5,087	8,651	4,528	7,805	393	633	166	213
3.2	Të rregjistruar si person juridik	1,293	11,854	1062	10642	106	632	125	580
3.2	Firma vendase	1,176	10,309	948	9,121	104	609	124	579
3.2	Ndërmarrje të përbashkëta	42	332	39	308	2	23	1	1
3.2	Firma të huaja	75	1,213	75	1,213	0	0	0	0

#### IV.1.2. Dega e Doganës Shkodër

Janë realizuar të ardhura nga Dogana, me një vlerë prej 5,002,962 mijë lekë nga 4,927,976 mije leke të planifikuara.

Si rezultat i bashkëpunimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe strukturat e policisë vendore është intensifikuar puna, për goditjen e fenomenit të fshehjes së detyrimeve doganore nga subjektet gjatë importit të mallrave

#### IV.1.3. Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore

Gjatë viti zbatim të akteve ligjore e nën ligjore dhe Rregulloreve të ISSH, institucioni është angazhuar për realizimin e detyrave të parashikuara dhe ato të dala gjatë vitit

Janë realizuar detyrat e për mbledhjen e të ardhurave nga kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi, kontributet vullnetare, si dhe ndjekjen në vazhdimësi të arketimit të detyrimeve nga



subjektet publike e private.

Janë arkëtuar për vitin 2023 të ardhura, kontribut për sigurime shoqërore e shëndetësore nga të vetëpunësuarit në bujqësi dhe sigurim vullnetar me vlerë 260,706 mijë leke nga 226,960 mijë lekë nga viti i kaluar (nga të vetëpunësuarit në bujqësi 230,195 mijë lekë dhe sig. vullnetar 30,511 mijë lekë) nga 222,000 mijë lekë të programuara.

Pra gjatë vitit janë realizuar detyrat e ngarkuara për mbledhjen e të ardhurave nga kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi dhe nga kontributet vullnetare me tejkalim të planit vjetor. Po kështu janë ndjekur në vazhdimësi kontributet e subjekteve shtetërore e private, mbledhja e të cilave është përgjegjësi e Drejtorisë Tatimore Rajonale. Dega e përfitime, gjatë vitit është përballur me një volum të konsiderueshëm pune duke shqyrtuar kërkesa të ndryshme, për përfitime, nga ligji 7703 datë 11.05.1993 ( i ndryshuar) dhe shërbime të ndryshme për 20948 shtetas. Jane caktuar 3190 pensione te reja, dhe jane mbyllur 1979 pensione. Po ashtu dega e arkives ka shqyrtuar 5426 kërkesa online. Gjithashtu janë trajtuar kërkesat sipas Ligjit 29/2019 “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, ku përfitues deri tani kanë rezultuar 14 pensionistë.

Për të gjitha rastet janë bërë llogaritjet dhe rillogaritjet, vendimet, kartelalat financiare si dhe pasqyrimi dhe gjenerimi i pagesës në sistemin PCAMS.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera (Posta shpallëse dhe të gjitha bankat e nivelit të dytë që operojnë në Qarkun Shkodër, Tatim Taksat, institucionet tek të cilat bëjnë verifikime të vjetërsive në punë ose kalojmë përfitimet e kategorive të ndryshme etj.) ka qenë pjesë e punës së përditshme

DRSSH Shkodër, plotëson të gjitha kërkesat për pensione të reja pleqeri, invaliditet, familjar, të gjithë llojet e tjera të përfitimeve suplementare, trajrimeve të ndryshme financiare, pafesive të perkohshme në punë, barrelindjeve etj. Po ashtu u jemi përgjigjur në kohë kërkesave për rishqyrtim pensioni duke rillogaritur pensionin, kur ky pëson ndryshim, ose duke kthyer përgjigje të kërkesës me shkrim, në rastet kur nuk përfiton shtesë. Pranë DRSSH-së Shkodër funksionon edhe Komisioni Rajonal i Ankimit (pjesë e procedurës administrative të ankimit), i cili trajton kërkesat, kompetence e tij. Po kështu pranë DRSSH-se Shkodër dhe Agjensive të saj, ekzistojnë kutitë e ankesave për pretendimet e çdo njeri.

#### **IV.1.4. Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit**

Puna e Drejtorisë është përqendruar në realizimin e planeve të Inspektiveve të miratuara nga DPAKU; Në realizimin e detyrimeve të planifikuara të treguesve financiar; Në zbatimin me rigorozitet të praktikave sipas ligjit (Ligji Nr.10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në R.Sh” me ndryshime; Nr. 9863, datë 28.01.2008 “Për ushqimin”, me ndryshime; VKM Nr. 1081, datë 21.10.2009 “Për organizimin dhe funksionimin e AKU”, me ndryshime), si dhe sipas planit kombëtar të kontrolleve (miratuar me Udhëzimit Nr. 2, datë 24.02.2020, me ndryshime)

DRAKU Shkodër gjatë periudhës 1/01/2023- 31/12/2023 ka realizuar gjithsej 2233 inspektime nga të cilat:

- 1499 inspektime në zbatim të planit vjetor me bazë rishikim kundrejt 1675 inspektime të programuara, për Sektorin e Ushqimit realizimi i planit konsiston në 87.75 % dhe për sektorin MBIB 424 inspektime në zbatim të planit vjetor me bazë rishikim kundrejt 428 inspektime të

programuara 98.1 %.

- Inspektime në PIK 14271 nga sektori OSH-OJSH-MBIB.

358 inspektime të paprogramuara për Sektorin e Kontrollit të Ushqimit-Terren, e përllogaritur kjo në 17.16 % të inspektimeve të pa programuara.

184 Inspektime në kuadër të “Sezonit Turistik 2023”.

- 36 Kërkesa për paisje me licencë.
- 31 Inspektime në kuadër të “Festave të fundvitit 2023”
- 28 Monitorime për mbetje të pesticideve.
- 17 Inspektime me Urdhër nga DPAKU.
- 11 Këkesa për “Akt miratimi i mjeteve të transportit”.
- 9 Inspektime si rezultat i daljes së përgjigjeve mbi normë.
- 8 Inspektime si nismë e Indiciove të ardhura.
- 6 Kërkesa për IPARD II.
- 6 Alert i ardhur nga AKMVB.
- 4 Alert nga ISUV-Tiranë.
- 4 Kërkesa për “Regjistrim fillestar nga QKB”.
- 4 Inspektime në kuadër të bashkpunim institucional .
- 3 Inspektime për zhbllokim
- 3 Inspektime për “Asgjesim me kërkesë të subjektit”.
- 1 Ri-inspektime të detyrave të lëna.
- 1 Inspektim me kërkesë të subjektit.
- 1 Inspektim në rast verifikimi nga PIK.
- 1 Asgjesim në raste bllokimi nga PIK.

3 inspektime të paprogramuara per Sektorin e MIBIB-së -Terren, e përllogaritur kjo në 1 % të inspektimeve të pa programuara.

- 2 Urdhër të DPAKU-së Tiranë
- 1 Kërkesë për paisje për Licensim:

Gjatë vitit 2023 janë marrë 557 mostra me 1207 analiza nga sektori i Kontrollit të Ushqimit dhe MBIB-së Terren për tu analizuar në laboratorët si më poshtë:

Gjate vitit 2023 janë marrë 125 mostra në zbatim të planit vjetor nga sektori i PIK Hani i Hotit. Gjatë vitit janë kryer 1,292 inspektime, me praktika të rregullta online nga sektorët e inspektimit në terren (nga të cilat sipas planit 1,107 inspektime, ose 84.2 % dhe 185 inspektime jashtë planit), 13,314 inspektime në PKK Hani Hotit (të praktikave të lëvizjes produkteve ushqimore, produkteve bimore për konsum, kafshë të gjalla, medikamente veterinare e plehra kimike), si dhe janë analizuar 389 mostra në laboratorin e DR

Nga inspektimet e kryera janë konstatuar dhe raste të mos përmbushjes së kërkesave ligjore:

- *Mungesë e gjurmueshmërisë së produkteve;*
- *Mos realizim i detyrave të lëna në afatet e përcaktuara;*
- *Mungesë etiketasg në gjuhën shqipe;*
- *Mos plotësim i kërkesave ligjore për sistemimin dhe etiketimin e produkteve ushqimore;*
- *Mosbashkëpunim OBU për dorëzimin e dokumentacionit, nga personat përgjegjës, me justifikime e arsye të ndryshme*

Për gjetjet e konstatuara gjatë ushtrimit të inspektimeve, jane marrë masa administrative

125 raste, nga të cilat:

- Gjobë në 9 raste, me vlerë 1,210 mijë lekë
- Paralajmërim, me qëllim eliminimin e parregullsive dhe shkeljeve të cilat nuk përbëjnë kundërvajtje administrative, në 100 raste
- Bllokim aktiviteti në 2 raste
- Bllokim produktesh në 5 raste
- Bllokim i produkteve të ndryshme ushqimore në 8 raste me një sasi prej 0.7 ton produkte, rreth 1000 lit. Lëngje dhe 10,306 kokrra vezë
- Asgjësim i produkteve të ndryshme ushqimore (*produkte të skaduara-kalim të afatit të përdorimit*) 2.46 ton

Gjatë vitit DRAKU ka patur një bashkëpunim të mirë me OBU, përfshirë edhe 13 kërkesat e ketyre subjekteve për asgjësimin e rreth 110 ton produkteve të skaduara.

Janë marrë në shqyrtim 84 kërkesa për “Notifikim Etikete” me 341 etiketa, nga ku ka rezultuar se 107 nuk janë konform VKM Nr. 434 dhe është lënë detyrë për korrigjim, ndersa 234 janë notifikuar

Po kështu gjatë vitit janë lëshuar 155 Çertifikata për eksport (119 për në vendet e BE-së dhe 36 jashtë ketyre vendeve)

#### **IV.1.5. Drejtoria e Rajonale e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive**

Drejtoria Rajonale e Agjencisë Kombëtare për Punësim e Aftësim, Shkodër, (AKPA), gjatë vitit ka ushtruar veprimtarinë në përmbushje të misionit dhe kryerjes së detyrave funksionale, Me fokus punësimin dhe mbështetjen e grupeve vulnerabël, për rritjen e mundësive të punësimit, ka bashkëpunuar dhe organizuar tryeza të rumbullakëta me pjesëmarrje nga grupet e interesit (të organizuara këto në ambientet e DRAKPA, apo edhe në bashki, Universitet, ShSSH dhe OJF të ndryshme, me të cilat është bashkëpunuar në vazhdimësi). Nisur nga detyrat funksionale (Shërbime të ndërmjetësimit, Shërbime të ndërmjetësimit në punë për të papunët që kërkojnë punë, të punësuarit që kërkojnë të ndryshojnë punë, personat me paaftësi të ndryshme dhe punëdhënësit; Shërbime të këshillimit profesional dhe të aftësimin për punësim a vetëpunësim për punëkërkuesit; Shërbim e pagesës së papunësisë për individët që e përfitojnë atë; Financim të punëdhënësve që krijojnë vende të reja pune ose që punësojnë të rinj të sapodiplomuar; Nxitjen e punëdhënësve që punësojnë persona me paaftësi; Formimin dhe riformimin profesional për punëkërkuesit dhe për të rinjtë në intervalin ndërmjet shkollës së mesme dhe të lartë; Kryerja e studimeve të autorizuara të tregut të punës, etj.), gjatë vitit mbi bazën e planit të treguesve të monitorueshëm nga Drejtoria Përgjithshme, është hartuar plani i veprimeve për realizimin e treguesve.

Është përmirësuar niveli i bashkëpunimit me institucionet qendrore në nivel vendor dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore, ku vlen të vlerësohet bashkëpunim me;

- DR SHSSH Shkodër për integrimin e kategorive në Ndihmë Ekonomike dhe PAK në tregun e punës dhe më gjërë.
- Bashkitë Fushë Arrëz, Pukë, Malësi e Madhe, Vau Dejës për implementimin e Programit të Nxitjes së Punësimit ‘Punë në komunitet’ me fokus integrimin e personave në Ndihmë ekonomike, në Tregun e Punës.
- DROFPP për rritjen e numrit të punëkërkuesve të papunë në Kurset e Formimit Profesional
- Universitetet për informimin e Programit të Nxitjes së Punësimit

- Shkollat Profesionale mbi informimin dhe regjistrimin në Zyrat e Punësimit, me qëllim integrimin në Tregun e Punës
- OJF në projekte të zbatuara në Qarkun Shkodër:  
Gjate vitit 2023 janë zhvilluar 31 lloje të kurseve nga të cilët 28 profesionale, 3 jo profesionale (nga të cilët 10 “Aftësi digjitale”, 4 “Gjuhë të huaja” dhe 7 “Start Smart”) Nga këto 31 lloje kurseve ishte planifikuar  
889 regjistrime gjithsej nga të cilat 621 në kurset profesionale, 268 në ato jo profesionale (prej të cilëve 150 në “Aftësi Digjitale”, 48 në trajnimin “Gjuhë të huaja” dhe 70 “Start Smart”  
830 punë kërkuar të papunë gjithsej nga të cilët 600 në kurset profesionale, 230 në kurse jo profesionale, ( prej të cilëve 150 në “Aftësi digjitale”, 10 në “Gjuhë të huaja” dhe 70 “Start Smart”  
Janë analizuar, zgjidhur, duke kthyer përgjigje 10 kërkesave të ardhura  
Në fund të vitit janë regjistruar punëkërkuar të papunë që ndjekin kurse profesionale 667 nga 600 që ka qenë objektivi.  
Bashkëpunimi me bizneset gjatë vitit 2023 është realizuar nëpërmjet:  
Përfshirjes së tyre në komisionet e provimeve përfundimtare të kurseve profesionale  
Nënshkrimit të 170 marrëveshjeve të bashkëpunimit për zhvillimin e praktikave profesionale, duke u përfshirë 441 kursantë.

#### **IV.1.6. Drejtoria Rajonale e Ofrimit Formimit Profesional Publik**

Bazuar në politikat qeveritare dhe Strategjinë kombëtare “PËR PUNËSIM DHE FORMIM”, u përcaktuan objektivat vjetore për formim profesional nëpërmjet zhvillimit të kurseve afatshkurtëra në bashkëpunim me Zyrat e Punësimit në rajon. Këto objektiva u përcaktuan me synimin e qartë për të plotësuar kërkesat e tregut të punës për personel të trajnuar, me prioritet punëkërkuar të papunë.

Është bërë planifikimi i zhvillimit të kurseve afatshkurtra të formimit profesional në përputhje me nevojat e tregut të punës, duke u fokusuar në përfshirjen e punëkërkuarve të papunë, me prioritet shtresat vulnerabël, ku në përfundim të procesit, dhe pas rishikimit të parashikimit sipas planit të AKPAS-s për treguesit e monitorueshëm sipas DROFPP-ve, është konkluduar për listën e kurseve që do të zhvillohen gjatë vitit, numrin e punëkërkuarve që do të përfshihen në këto kurse, si dhe janë parashikuar afatet e zhvillimit të tyre, duke planifikuar hapjen dhe zhvillimin e llojeve të kurseve profesionale e të tjera jo profesionale (Anglisht & Gjermanisht) dhe trajnimin «Start SMART+19».

Në përmbushjen e detyrave funksionale gjatë vitit ka patur një bashkëpunim të mirë me institucionet vendore dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore

#### **IV.1.7. Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor (Seksioni i Ekstensionit Bujqësor Shkodër)**

Drejtim kryesor i këtij i veprimtarisë është rritja e efektivitetit të shërbimeve të ekstensionit për këshillim, trajnim dhe sigurim informacioni në Qendrat e Informacionit Bujqësor e më gjerë, nëpërmjet realizimit cilësor të programeve dhe aktiviteteve të planifikuara, në përputhje me prioritetet dhe tendencat e zhvillimit të bujqësisë, politikave dhe strategjive të MBZHR

Numri i fermave brenda territorit të qarkut (me një sip, shumë të madhe gjeografike, e shtrirë nga bregdeti deri në lartësinë mbi 2000 m, ku kultivohen një larmi bimësh e kulturash

bujqësore) ka qenë 43,902. Numri i fermerëve të paisur me NIPT ka ardhur në rritje nga vitit në vit nga 4,757 fermerë në vitin 2019, 5,187 në vitin 2020, 6,038 në vitin e kaluar, ndërsa në vitin 2022 ka qenë 7,030 me një rritje prej 992 fermerë krahasuar me vitin e kaluar

Prioritet dhe objektivat e ekstensionit (zbatimi i udhëzimeve të MBZHR dhe MFE mbi skemat kombëtare në bujqësi dhe shpërndarjen e informacionit) dhe sektorët strategjikë (Prodhimi dhe grumbullimi i BAM-ve ; Prodhimi i pemëve frutore dhe perimeve ; Prodhimi dhe përpunimi industrial i fruta perimeve ; Prodhimi dhe përpunimi industrial i produkteve të qumështit dhe mishit ; Prodhimi i drithërave të bukës, fasules dhe patates) kanë qenë të orinetuar drejt sistemeve bujqësore në zhvillim, jo si një shërbim i izoluar, por një shërbim kompleks ku përfshihet i gjithë sistemi i gjenerimit, transformimit, përhapjes dhe përdorimit të informacionit dhe njohurive në fushën e bujqësisë. Gjatë vitit Qeveria Shqiptare subvencionoj edhe kulturën e grurit, kulturë për të cilën përfituan 333 fermerë, nga 512 fermerë aplikant

Për skemën e naftës falas, kanë aplikuar dhe janë shpërndarë 3879 karta brënda dt 31.12.2023 dhe janë pajisur me NIPT 1180 fermere gjatë vitit 2023.

Në skemat kombëtare kanë aplikuar 3890 fermere nga 2130 fermerë për vitin 2022, nga të cilët kanë përfituar 3879 aplikues

- Për tufën bazë të matrikulluar	760
- Mbarështim bletarie	585
- Inpute për fara e fidanë	22
- Ferma organike	44
- Certifikimi global gap	1

Për kryerjen e veprimtarisë është bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet vendore, shoqata e organizata dhe fermerë, bashkëpunim i cili ka qenë i mirë.

#### **IV.1.8. Drejtoria e ujitjes dhe kullimit Lezhë (Sektori Shkodër)**

Drejtoria e Ujitjes dhe Kullimit, në Qarkun Shkodër ka në administrim 151.1 km kanale të parë kullues, 63.9 km argjinatura mbrojtëse nga përmytjet, rrjet të parë ujitës me gjatësi 180 km si dhe një rezervuar për ujitjen e tokave bujqësore (rezervuari i Shtodrit)

Janë kryer shpenzime për investime, rehabilitim e punime të domosdoshme, me fondet e buxhetit të financuara nga MBZHR, për përmirësimin e sistemit të ujitjes e kullimit dhe mbrojtjen nga gërryerjet e lumenjve me vlerë 170,758 mijë lekë (Investimet kryesore gjate periudhes 2022 dhe kane vazhduar ne 2023 mund të përmendim, “Argjinatura e lumit Buna, Dajç-Shirgj” 42,846 mijë lekë; “Mbrojtje nga lumi Buna, Kisha e shirgjit , Shkoder” 43,802 mijë lekë; “Rehabilitimi i argjinatures Darragjat, segmenti Pk. 26-33,, L=170m” 13,287 mijë lekë) ndërsa ndër investimet kryesore që vazhdojnë edhe në vitin 2024 kemi: “Mbrojtje nga Lumi Drin në Juban” me vlerë 66,726 mijë lekë, “Rehabilitim I kanalit ujitës KU-3 Berdice, L=8.5km” me vlerë 3,825 mijë lekë, “Mbrojtje nga lumi Kir, ura e Bardhajve” me vlerë 2,426 mijë lekë, “Mbrojtje tërthore e argjinaturës Darragjat (punime emergjente) me vlerë 5,849 mijë lekë.

Gjatë vitit janë kryer punime në objekte të kullimit dhe të ujitjes, punime rehabilituese të programuara dhe të domosdoshme

Janë marrë masa dhe është punuar në forcimin e argjinaturave

#### **IV.1.9. Zyra e Administrimit të Basenit Ujor Drin-Bune**

Veprimtaria e Zyrës së Administrimit të Basenit Ujor mbështetet në Ligjin Nr. 111, datë 15.12.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, me ndryshime; VKM Nr. 550, datë 15.07.2020 “Për miratimin e Formularëve të kërkesës për miratim në parim, për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor e lejes/autorizimit në përdorimin e burimit ujor”, Rregullores së Këshillit të Basenit Ujor (miratuar me Vendimin Nr. 06, datë 12.06.2019 të Këshillit të Basenit), si dhe planeve të punës të hartuara e miratuara, sipas problemeve të veçanta

Gjatë vitit janë zhvilluar 5 mbledhje te Keshillit te Basenit Ujor Drin-Bune (23.02.2023, 06.04.2023, 12.07.2023, 26.09.2023, 09.11.2023) ku janë trajtuar problematika të ndryshme për burimet ujore dhe janë miratuar 22 propozime, të cilat detajohen: 6 miratime për subjektet që përdorin ujin për prodhim energjie, 1 miratime për subjektet që përdorin ujin për proces teknologjik, 2 miratime për subjektet që përdorin ujin në akuakulturë, 5 miratime për subjektet që përdorin ujin për qëllime të tjera të pa përfshira, 2 miratime për subjektet që kanë veprimtari në brigje, 2 transferim leje, 2 ndryshime sistemime koordinatash dhe 2 shfuqizime leje përdorimi burimi ujor.

Gjate vitit janë planifikuar 146 monitorime në terren në subjektet me leje përdorimi të burimeve ujore që i përkasin këtij baseni dhe janë realizuar 201 monitorime ku 35 janë monitorime të subjekteve që përdorin ujin për prodhim energjie, 3 monitorime të subjekteve që përdorin ujin për inbotim, 13 përdorues teknologjik, 6 monitorime të përdoruesve në akuakulturë, 1 monitorim në përdorues turistik, 10 monitorime në përdorues të ndryshëm, 1 monitorim për veprimtari në brigje, 132 monitorime nga ankesat apo verifikime jashtë planeve të punës.

Kërkesat/aplikimet e subjekteve për t'u paisur me leje /autorizim në fushën e rezervave ujore paraqiten online (platformën e-albania) dhe dokumentacioni shqyrtohet nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Mbi bazën e procesverbaleve të leximit të matësve dhe të deklarimeve të sjella nga subjektet, janë faturuar të ardhura (191 fatura) me vlerë 154,280 mijë lekë, nga 101,057 mijë lekë të planifikuara, me një tejkalim prej 53,223 mijë lekë Po të bëjmë krahasimin plan/faturim kemi një rritje të faturimeve për periudhën Janar- Dhjetor 2023 dhe kjo ka ardhur kryesisht nga futja në prodhim e HEC-ve të reja dhe rritja e çmimit të shitjes së energjisë.

ZABU Drin-Bunë, gjatë vitit 2023 ka kërkuar bashkëpunim, IKMT-së, Agjensinë Kombëtare të Mjedisit për procedim të mëtejshëm për 126 përdorues pa leje të autoritetit të ujit të evidentuara në basenin Drin-Bunë si dhe për subjektet që janë debitorë ndaj buxhetit të shtetit. ZABU Drin- Bunë ka marrë pjesë aktive në të gjitha seminarët dhe takimet e organizuara në rang qarku mbi problematikat e ndryshme në basenin tonë.

Janë ndjekur në terren ankesat e ardhura nga institucione dhe individë në lidhje me fushën e rezervave ujor. Janë hartuar relacionet përkatëse dhe përgjigjet brenda afateve ligjore.

Janë dërguar shkresa "kërkesë për bashkëpunim dhe vënie në dijeni", bashkive dhe institucioneve që kanë ndikim në fushën e rezervave ujore, për të aplikuar për burimet ujore që administrojnë si për vaditje apo për furnizim popullate.

Gjithashtu, ZABU Drin- Bunë gjatë vitit 2023, ka ndjekur çështjet gjyqësore që i përkasin basenit Drin-Bunë konkretisht;

-çështjen e subjektit "Tamara"shpk me objekt: 1-Shfuqizimin e vendimit Nr.19, date 07.03.2018, për mosmiratimin në parim të kërkesës për përdorim të burimit ujor për energji elektrike, subjektit "Tamara" Shpk dhe 2-Detyrimin e palës së paditur të nxjerrë aktin e miratimit

të kërkesës së subjektit “Tamara” Shpk, për përdorimin e burimit uJOR Lumi i Cemit, për prodhim Hidroenergji për HEC Grabom dhe H/C Brojë.

Subjekti “Tamara” Shpk ka tërhequr padinë e sipërcituar për të dy H/C.

- çështjen e subjektit "Seman Sunpoëer" me objekt 1-Shfuqizimin e vendimit Nr.17, datë 07.03.2018, për mosmiratimin në parim të kërkesës për përdorim të burimit uJOR për energji, elektrike, subjektit “Seman Sunpoëer” Shpk. 2-Detyrimin e palës së paditur të nxjerrë aktin e miratimit të kërkesës së subjektit “Seman Sunpoëer” Shpk, për përdorimin e burimit uJOR Lumi i Cemit për prodhim hidro-energji (HEC Peshtan).

Gjatë vitit u është dërguar shkresë zyrtare subjekteve debitore, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, si dhe Sh.A të Ujësjellës Kanalizimeve, të cilat akoma nuk kanë kontratë me Zyrën e Basenit.

#### **IV.1.10. Administrata e Zonave të Mbrojtura**

Gjatë këtij viti janë kryer monitorime të vazhdueshme për mbrojtjen e ZM-ve dhe parandalimin e aktiviteteve të paligjshme në to, në këtë kuadër, për këtë vit janë realizuar në total 2148 monitorime, nga ku, 390 monitorime në Parkun Kombëtar Alpet e Shqipërisë, 781 monitorime në RNM Liqeni i Shkodrës, 717 monitorime në PUTM Lumi Buna — Velipojë, 146 monitorime në PN Lupina e Shalës, 114 monitorime në PN Munellë.

Gjatë ushtrimit të kontrolleve dhe patrullimeve në terren janë mbajtur 19 proces-verbale konstatimi (16 me autor dhe 3 pa autor), në rrejetin e zonave të mbrojtura të Qarkut Shkodër, nga ku, 9 (nëntë) me dëmtim të fondit pyjor në PK Alpet e Shqipërisë 1 (një) penal dhe 8 (tetë) administrativ, në RNM Liqeni i Shkodrës 3 (tre), nga këta 2 (dy) penal dhe 1 (një) administrativ, në PUTM Lumi Buna-Velipojë 4 (katër) nga këta 1 (një) penal dhe 3 (tre) administrativ, në PN Munellë 3 (tre) nga këta 3 (tre) penal.

Nga këto monitorime:

Nr. i kundravajtjeve është 19.

Gërmime -1685m<sup>2</sup>, 7 raste

Hapje rruge -250 ml dhe Shpyllëzim -0,263 1(një) rast;

Transport materiali drusor - 4.5 mst. 2 raste;

Prerje drurësh 188 copë, 4 raste.

Zënie në fond pyjor 5 raste.

Dokumentacioni i mbajtur për secilin nga rastet është referuar tek AKZM si dhe tek:

IKMT dhe Policisë të Shtetit :8 raste.

Prokurorisë së Rrethit : 7 raste.

IKMT: 4 raste.

#### **IV.1.11. Arsimi**

Nga ana e bashkive në Qarkun Shkodër janë marrë masa për rritjen e sigurisë në shkolla si dhe për përmirësimin e infrastrukturës së tyre, duke krijuar kushtet për zhvillimin e mësimin brenda standarteve të përcaktuara në VKM Nr. 316, datë 12.04.2017.

Janë realizuar e janë në proces punime rikonstruksioni, përmirësim i ambjentëve dhe infrastrukturës në objektet e shkollave. Sipas informacionit të dërguar pranë institucionit të

Prefektit Shkodër janë kryer punimet e mirëmbajtjes dhe lyerjes së objekteve të shkollave në të gjitha bashkitë (sistemim i ambjenteve të brendshme dhe të jashtme; lyerje e ambjenteve të brendshme; sistemim i rrjetit elektrik dhe atij hidraulik, riparime të dyerve dhe dritareve, të mobiljeve, pastrime oborresh, riparime të çatave, riparime të pompave të ujit etj).

Në lidhje me kushtet higjieno-sanitare, në fillim të vitit shkollor janë shpërndarë në të gjitha shkollat e Bashkisë Shkodër materiale pastrimi. Gjithashtu është bërë shpërndarje e materialeve të kancelarisë.

Nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit, në Bashkinë Shkodër, janë marrë masa për të mundësuar ngrohjen në të gjitha shkollat. Për rritjen e sigurisë dhe garantimin e shëndetit të nxënësve dhe personelit mësimor është bërë zëvendësimi nga ngrohja me gaz në sistem tjetër ngrohjeje (kaldajë, ose soba me dru zjarri), në ndryshim nga viti shkollor paraardhës, këtë vit ka vetëm 5 shkolla në të cilat ka sistem të ngrohjes me gaz, në të cilat duhet të merren masa për zëvendësimin me sistem tjetër ngrohjeje.

Nga ana e Zyrave Vendore Arsimore dhe Bashkive janë marrë masa për plotësimin e shkollave me personelin mësimor dhe mbështetës, dokumentacionin e domosdoshëm, si dhe ofrimin e shërbimit të pastrimit, furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm.

Nga ana e njërive të vetëqeverisjes vendore, në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë, AKU, IKMT dhe institucione të tjera, janë marrë masa me qëllim garantimin e sigurisë dhe parandalimin e kriminalitetit në mjediset shkollore dhe hapësirat përreth tyre. Janë marrë masa në vendosjen e sinjalistikës rrugore vertikale dhe horizontale, vendosjen e kamerave të sigurisë dhe pajisjeve për shuarjen e zjarrit dhe marrjen e masave ndërgjegjësuese për shmangien e rrezikut nga zjarri në shkolla, kontrolli i vazhdueshëm i kushteve të sigurisë ushqimore dhe pajisjen me licence të operatorëve të bizneseve ushqimore që veprojnë në perimetrin përreth shkollave.

Janë marra masa për shtimin e oficerëve të sigurisë, të cilët raportojnë cdo javë pranë Zyrave Vendore Arsimore të dhëna për raste konfliktuale të ndodhura në ambientet shkollore. Deri më tani në Bashkinë Shkodër, 9 shkolla kanë oficer sigurie. Gjatë vitit 2024 pritet që numri të shkojë në 13 shkolla. Ndërsa në Bashkinë Vau i Dejës vetëm një shkollë ka oficer sigurie.

Nga ana e shërbimeve të policisë së DVP Shkodër janë marrë të gjitha masat për mbajtjen në kontroll të situatës në institucionet arsimore të Qarkut Shkodër. Janë angazhuar me shërbim për sigurinë në shkolla 1048 punonjes policie, janë kryer 2711 takime me drejtuesit e shkollave për trajtimin e problematikave brenda perimetrit të sigurisë, janë realizuar 849 takime me oficerët e sigurisë në shkolla, janë realizuar 48 takime me bordin e prindërve dhe senatin e nxënësve.

Nga të dhënat e Zyrave Vendore Arsimore, në Qarkun Shkodër janë gjithsej 205 shkolla (96 në Bashkinë Shkodër, 26 në Bashkinë Vau i Dejës, 38 në Bashkinë Malësi e Madhe dhe 45 në Bashkinë Pukë dhe Fushë Arrëz). Në Vaun e Dejës janë mbyllur 2 shkolla për shkak të numrit të ulët të nxënësve.

Numri i nxënësve në Qarkun Shkodër për vitin shkollor 2023-2024 është 21 234 nxënës (15 803 nxënës në Bashkinë Shkodër, 1953 në Bashkinë Vau i Dejës, 2248 në Bashkinë Malësi e Madhe dhe 1230 në Bashkinë Pukë dhe Fushë Arrëz). Ky numër rezulton të jetë më i ulët sesa vitin e kaluar, me një diferencë prej 2599 nxënës më pak, ose 10.9% më pak.

Pavarësisht masave të marra dhe punës së realizuar, akoma evidentohen problematika të cilat ndikojnë në ecurinë normale të procesit mësimor, si:

- Mungesa e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale në afersi të shkollave, në zonat në periferi të qytetit;
- Pajisja me kamerat e sigurisë në ambientet shkollore;
- Mungesa e shërbimit të furnizimit me energji elektrike dhe ujë të pijshëm kryesisht në zonat malore;
- Sigurimi i shërbimit të transportit të nxënësve nga vendbanimi në shkollë.



Për eliminimin e problematikave që janë evidentuar nga monitorimi, janë dhënë rekomandimet përkatëse, zbatimi i të cilave është ndjekur në vazhdimësi. Për kryerjen e veprimtarisë, sigurimin e zhvillimit normal të procesit mësimor, brenda standarteve të kërkuara, është bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet vendore, shoqata e organizata të ndryshme, të cilat operojnë në qark.

#### **IV.1.12. Shërbimi Shëndetësor**

Veprimtaria e institucioneve shëndetësore për zbatimin e detyrimeve ligjore është ofrimi i shërbimit shëndetësor nëpërmjet kujdesit shëndetësor dhe spitalor

Veprimtaria e institucioneve shëndetësore në qark monitorohet në menyrë të vazhdueshme nga Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Shkodër (në përputhje me VKM Nr. 419, datë 04.07.2018 “Për krijimin, menyrën e organizimit dhe të funksionimit të OSHKSH” dhe Rregullores së brendshme “Për menyrën e organizimit dhe funksionimit të OSHKSH”- miratuar me Urdhrin Nr.18)

Drejtoria Rajonale e Operatorit të Kujdesit Shëndetësor Shkodër përfshin qarqet Shkodër, Lezhë dhe Kukës.

Për Vitin 2023, Droshksh-Shkodër në zbatim të detyrave të saja funksionale ka kryer veprimtarinë si vijon:

Ka planifikuar nevojat për shërbime të kujdesit shëndetësor parësor, shëndet publik dhe spitalor në territorin që mbulojmë;

Ka koordinuar, monitoruar dhe siguruar ofrimin e shërbimit shëndetësor parësor dhe shëndet publik pranë vendbanimit për të gjithë qytetarët;

Ka kryer procedurat për menaxhimin e burimeve njerëzore në sistemin shëndetësor parësor, shëndet publik dhe spitalor (planifikimi i nevojave, rekrutimi);

Ka monitoruar zbatimin e normave dhe standarteve lidhur me mbulimin e popullatës me mjekë familje dhe infermierë në kujdesin shëndetësor parësor e spitalor;

Ka kontrolluar dhe monitoruar realizimin e indikatorëve të cilësisë së shërbimit mjekësor në kujdesin shëndetësor parësor dhe spitalor;

Ka kontrolluar dhe monitoruar ecurinë e investimeve në rajon;

Ka shqyrtuar përdorimin e të ardhurave dytësorë dhe rialokimeve brenda zërave të buxhetit për orfruesit e shërbimit shëndetësor që ka në juridiksion dhe ja përcjell Operatorit Qëndror për miratim në parim.

Ka organizuar dhe bashkërenduar punën për ofrimin e shërbimeve bazë të shëndetit publik dhe të shërbimeve të tjera ndihmëse sipas paketës së shërbimeve të shëndetit publik.

Njesia vendore e kujdesit shëndetësor Shkoder mundëson monitorimin dhe ndjek hap pas hapi zbatimin e paketës baze të shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor, monitoron aktivitetin e Q.Sh, Amb, Konsultor i Gruas dhe Femijes, monitoron aktivitetin e Q.Sh turistike në sezonin veror, bashkëpunon dhe monitoron realizimin e detyrave të shërbimit shëndetësor në shkollë dhe konvikte.

Per te dytin vit radhazi eshte zhvilluar Programi i Depistimit te shikimit ne shkolla npr mjekëve te familjes dhe me ndihmen e infermiereve ne 42 shkolla. Jane realizuar 665 depistime ne total.

Jane planifikuar 27697 persona per te kryer check up dhe jane realizuar 26975, ne krahasim me

vitin e kaluar rezultojnë rreth 3679 paciente me shume.

#### **IV.1.13. Drejtoria Rajonale e Inspektoratit Shteteror të Punes dhe Sherbimeve Shoqerore**

Nga ana e Drejtorisë Rajonale IShPShSh, për kryerjen e veprimtarisë dhe për çështje me objektiv të përbashkët, është bashkëpunuar me institucionet Rajonale Tatimore, Sigurimeve Shoqerore, Agjencësi Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Spitalin Rajonal, Drejtorinë Vendore të Policisë, etj.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 janë kryer 309 inspektime nga të cilat;

- 255 inspektime të programuara;
- 8 inspektime rastësore;
- 8 inspektime, për aksidente;
- 15 inspektime, verifikim ankesa
- 16 inspektime, në kuadrin IPARD

Nga inspektimet e kryera ka rezultuar:

- Punëmarrës të padeklaruar 179 persona, të cilët janë futur në skemen e sigurimeve shoqerore brenda afatit të inspektimit.

Për shkeljet e legjislacionit të punës, të gjetura nga inspektimet e kryera, janë marrë masa:

- Masa urgjente për marrëdhëniet e punës 211
- Masa urgjente për sigurinë dhe shëndetin në punë 33
- Paralajmërim për sanksione 6
- Vendosje gjobë 8

Gjatë vitit janë shqyrtuar edhe 15 ankesa të ardhura nga sli.gov.al dhe nga portali i bashkëqeverijes ku shumica e të cilave janë zgjidhur në favor të punëmarrësve

#### **IV.1.14. Dega Rajonale e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor**

Në përmbushje të detyrimeve ligjore (Ligji Nr. 10433 datë 16.11.2011 “Për inspektimin në RSh”; Nr. 15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe semuindjeve infektive”, me ndryshime; Nr. 9636 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar nr. 9518 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”; Nr. 9518 “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”; Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”; VKM Nr. 241, datë 27.03.2011 “Për organizimin dhe funksionimin e ISHSH”;; arritjes së objektivave, për rritjen e sigurisë së produkteve dhe shërbimeve që ofrohen në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjen e konsumatorit nga rrisqet dhe kërcënimet e mundshme dhe planeve të hartuara e miratuara, sipas çështjeve me tematikat, janë ushtruar 1957 inspektime e 172 riinspektime në subjekte publike e private (Inspektime 1785, përfshi 38 inspektime jashtë planit; riinspektime 172 dhe 131 inspektime per duhanin). Po kështu janë kryer 1411 inspektime ne qendrat e kujdesit te femijeve, e kujdesit te moshuarve, tregtimi i kozmetikës, duhanit, alkoolit, arsim, subjekte akomodim, farmaci, pishina, bare, restorante dhe 131 inspektime per duhanin. Jane kryer 448 inspektime shendetesore dhe 98 inspektime jashte programit te inspektimit.

Për gjetjet e konstatuara, janë marrë 19 masa administrative, nga të cilat;

- 18 gjoba me vlerë 500 mije leke;
- Mase urgjente te specifikuar ne fushat perkatese.

Kërkesat e ardhura pranë ISHSH kanë të bëjnë më së shumti me kërkesat për tu pajisur me Akt-miratim Higjieno-sanitar dhe kërkesa për akreditim. Shqyrtimi i tyre është realizuar brenda afateve kohore dhe janë lëshuar në total 91 Akt-miratime higjieno-saitare për vitin nga të cilat 37 me kërkesë të subjektit. Gjithashtu janë realizuar dhe 15 inspektime me kërkesë për akreditimin dhe 2 denoncime të përmendura në fushat perkatese.

ISHSH gjatë këtij vitit ka pasur bashkëpunim me njsitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet vendore, për zbatimin e detyrimeve ligjore

#### **IV.1.15. Drejtoria Rajonale e IKMT**

Në zbatim të detyrimeve ligjore Drejtoria Rajonale e IKMT gjatë vitit 2023, ka përmbushur detyrat institucionale për:

**1. Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave** është fokusuar në zbatimin e ligjshmërisë në respektimin e normave dhe standarteve në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së mjedisit dhe burimeve ujore.

**2. Sektori i Inspektimit të Pyjeve (SIP)** është fokusuar në zbatimin e ligjshmërisë në fondin pyjor/kullosor përmes mbikqyrjes, parandalimit, zbulimit, hetimit dhe ndëshkimit nga ndërhyrjet e kundraligjshme duke përfshirë edhe mbrojtjen faunës, zbatimin e moratoriumit në gjueti, pyje dhe bimëve medicinale, eterovajore dhe tanifere.

**3. Sektori i Inspektimit të Territorit** është fokusuar në zbatimin e ligjshmërisë dhe parandalimin e zhvillimeve të paautorizuara, pa leje ndërtimi në territor, të shkeljeve të kushteve të lejeve, kondicioneve urbane dhe legjislacionit në fushën e ndërtimit.

**Sektori i Inspektimit të Territorit pranë DRIKMT Shkodër** për periudhën Janar – Dhjetor 2023 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

Përgjatë vitit 2023 janë planifikuar për të ushtruar kontroll në zonat e mbrojtura dhe zonat me përparësi zhvillimin e turizmit.

Janë administruar dhe 3 ankesa nga subjekte, shkresa të cilave i është kthyer përgjigje.

Më anë të postës elektronike janë administruar 11 ankesa.

Në bashkëpunim me inspektorët pranë IKMT-Qendër kanë inspektuar 37 subjekte në zonën e Velipojës,

Në bashkëpunim me inspektorët pranë IKMT-Qendër kanë inspektuar pikat doganore Muriqan dhe Hani i Hotit ku janë konstatuar 12 kioska.

Në bashkëpunim me Sektorin e Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave kanë inspektuar 26 shkolla në Qarkun Shkodër për kontrollin e perimetrit të sigurisë pranë ambjenteve të shkollave.

Në bashkëpunim me inspektorët pranë IMT Bashkia Shkodër kanë inspektuar subjekte në Lumin e Shalës.

Janë mbajtur 11 procedura administrative.

**Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave** për periudhën Janar – Dhjetor 2023 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

Përgjatë vitit 2023 janë planifikuar 10 inspektime në përmbushje të detyrimeve ligjore në fushën e mjedisit dhe ujërave. Nga inspektimet e planifikuara janë realizur të gjitha inspektimet, ku nuk janë konstatuar shkelje në fushën e mjedisit dhe ujërave,

Gjithashtu janë administruar dhe 5 ankesat e ardhura me anë të postës elektronik, ku është bërë verifikimi në terren dhe është dhënë zgjidhje për të gjitha rastet.

Ka inspektuar Zonën përgjatë bregut të Liqenit të Shkodrës ku është bërë azhurnimi i gjithë zonës duke evidentuar nëse kemi hedhje të mbetjeve të ndryshme si dhe shkarkime të ujërave të ndotura.

Nga Sektori i Inspektimit të Mjedisit dhe Ujërave janë mbajtur 4 procedura administrative.

**Sektori i Inspektimit të Pyjeve** për periudhën Janar – Dhjetor 2023 e ka përqendruar vëmendjen kryesore në këto drejtime:

Ka ushtruar funksionin e saj në garantimin e respektimit të kërkesave ligjore në fushën e mbrojtjes së pyjeve në disa drejtime kryesore siç janë:

- Mbrojtja e florës dhe e faunes si dhe mbrojtja në pergjithësi e mjedisit pyjorë.
- Parandalimi, hetimi dhe ndeshkimi i dëmëve në pyje dhe ndeshkimi sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fondin pyjorë e kullosor të Qarkut Shkodër.

Nga Sektori i Inspektimit të Pyjeve janë mbajtur 3 procedura administrative.

#### **IV.2. Problemet e rendit dhe të sigurisë, rekomandime për përmirësimin e punës në vazhdim**

Gjatë vitit janë evidentuar 1864 vepra penale. Si rezultat i organizimit të veprimtarisë hetimore, janë arritur të mblidhen fakte dhe prova, duke zbuluar dhe dokumentuar autorësinë e 1655 prej tyre, me një zbulueshmëri 88.8%. Është dokumentuar implikimi i 1741 autorëve të dyshuar të veprave penale.

Evidentimi dhe referimi në prokurori i veprave penale, si dhe zbulueshmëria e tyre për vitin 2023 e 2022, sipas të dhënave të Drejtorisë Vendore të Policisë, paraqitet:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Viti	
			2022	2023
1	Vepra penale të evidentuara dhe të referuar në prokurori	Numër	1,939	1864
2	Vepra penale për të cilat janë zbuluar autorët	“	1,700	1655
3	Persona të implikuar,	“	1,793	1741
	Nga të cilët			
	-U është privuar liria (arrestuar)	“	345	315
	-Janë ndaluar	“	56	89
	-Janë ndjekur në gjëndje të lirë	“	1,297	1239
	-Janë shpallur në kërkim (janë larguar, apo i fshihen drejtësisë)	“	195	98

Në strukturën e veprave të evidentuara vendin e parë me 99 % e zënë veprat penale në fushën e krimit ekonomiko-financiar, vendin e dytë me 25 % veprat në fushën e qarkullimit rrugor, vendin e tretë me rreth 19 % veprat penale të tjera, vendin e katërt me 15% veprat penale të narkotikëve dhe kultivimiku është synuar goditja e shpërndarësve në afërsi të shkollave në bazë të operacionit “Tempulli” etj.

Numri i veprave penale të evidentuara dhe të zbuluara gjatë viteve 2017-2023, paraqitet:

Nr.	Vepra penale	Viti						
		2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023
1	Të evidentuara	2,306	2,292	2,081	1,754	2,004	1,939	1864
2	Të zbuluara	2,019	2,050	1,889	1,627	1,760	1,700	1655

Nga studimi i kriminalitetit rezulton se në vitin 2023 krahasuar me vitin e kaluar ka pësuar ulje në masën 4 % ose 81 vepra penale më pak; Ndërsa shkalla e zbulueshmërisë gjatë viteve 2022-

2023 është rritur zbulueshmeria 1%, afro 46% e kriminatitetit është evidentuar në qytet dhe 54% në zonat rurale.

Në fushën e qarkullimit rrugor janë evidentuar 463 vepra penale dhe janë zbuluar 459 me një zbulueshmëri 99%.Janë vendosur 42059 masa administrative.Risi në fushën e qarkullimit rrugor ka qënë futja e makinës inteligjente dhe largimi i shërbimeve policore nga akset rrugore nacionale e cila ka dhënë impaktin e vet në rritjen e parametrave të sigurisë në fushën e qarkullimit rrugor.

### **Rekomandime për përmirësimin e punës**

1. Rritja e bashkëpunimit dhe e koordinimit mes të gjithë aktorëve, marrëdhëniet direkte me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet qendrore në nivel vendor (Degët Territoriale), duke krijuar struktura (grupe ndërinstucionale) të veçanta bashkëpunimi, për shërbimet e ndërsjella të policisë vendore, policisë bashkiake dhe institucioneve qendrore në nivel vendor (duke analizuar periodikisht nivelin e bashkëpunimit dhe rezultatet e arritura) për:

a. Kontrollin efektiv të territorit, me qëllim parandalimin e;

- Ndërtimeve pa leje;
- Krimeve mjedisore (ndotja e mjedisit nga mbetjet, me vemendje të shtuar brigjet dhe shtratin e lumenjve, liqenin e Shkodrës dhe ato të HEC-ve, rrugët kombetare, destinacionet turistike; prerja e paligjëshme dhe dëmtimi i pyjeve, etj);

- Kultivimit të bimëve narkotike si dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të përdoruesve të tyre. Në luftën goditëse ndaj bimëve narkotike, parësore mbetet puna parandaluese në kultivimin e tyre dhe për të cilën duhet një mbikëqyrje e rreptë dhe e vazhdueshme në Menaxhimin e burimeve njerëzore, që merret me aktivitetin e paligjshëm të bimëve narkotike, sipas periudhave (Në periudhën përgatitore dhe kultivimit, që nga punimi dhe përgatitja e sipërfaqeve për mbjellje; lëvizja e farave dhe fidanëve e cila kryhet nga zonat urbane në ato rurale; tregtarët, transportuesit dhe personat e tjerë potencial për tu marrë me këtë aktivitet të paligjshëm) dhe njësitë administrative e fshatrave (Ato Nj. A, fshatra, zona dhe sipërfaqet të cilat janë të njohura për kultivimin apo mundësinë e kultivimit të bimëve narkotike);

- Ndotjes akustike, me vemendje të shtuar ndotjen nga zhurma e automjeteve (ndërrhyrjet dhe modifikimi i mjeteve, përfshi edhe motorët, të cilët gjenerojnë zhurma tej normave të lejuara dhe të besdishme për qytetarët);

- Aksidenteve rrugore e disiplinimit e trafikut rrugor, nëpërmjet shërbimeve të përbashkëta të struktura të policisë me ato të institucioneve përgjegjëse e të njësitë të vetëqeverisjes vendore (vendosjen e sinjalistikës rrugore dhe përcaktimin e vendqendrimeve të mjeteve të transportit të udhëtarëve)

b. Evidentimin dhe goditjen e individëve/grupeve të ndryshëm, të cilët kryejnë aktivitetin kriminal të trafikimit të personave dhe shfrytëzimit të të miturve (për kryerje vepra kriminale, punë të detyruar, lypje në rrugë, etj) me qëllim parandalimin e trafikimit të personave, me vemendje të shtuar komunitetin rom e egjyptian, si dhe fëmijët e rrugës

c. Hartimin e planeve të përbashkëta operacionale dhe shkëmbimin e informacioneve të ndërsjella lidhur me:

- Zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë natyrore dhe realizimin e mbrojtjes civile, për të garantuar mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës dhe të trashëgimisë kulturore e të mjedisit;

- Marrjen e masave për ruajtjen e rendit dhe sigurisë gjatë zhvillimit të aktiviteteve të ndryshme (kulturore, sportive, etj), tubimeve, apo në raste festash kombëtare e lokale;

- Marrjen e masave për parandalimin dhe goditjen e krimit ekonomik-financiar e kibernetik;

- Marrjen e masave për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik

2. Bashkëpunimi me institucionet arsimore (Zyrat Vendore të Arsimit, shkollat e sistemit parauniversitar dhe universitetin “Luigj Gurakuqi” Shkoder) për parandalimin e përdorimit të lëndëve narkotike jo vetëm në ambientet e shkollave dhe universitetit, por edhe jashtë këtyre ambienteve nga nxënësit dhe studentët, si kontingjenti më i rrisuar.

### **IV.3. Grupet ndërinstitucionale të punës (task-forcat)**

Prefekti i qarkut ka drejtuar grupet ndërinstitucionale (task forcen vendore), duke qenë pjesë përbërëse e tyre, për:

Koordinimin dhe bashkëveprimin efektiv të veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor dhe të këtyre Institucioneve me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kontrollin efikas të territorit me qëllim parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit, si dhe monitorimin dhe kontrollin e veprimtarisë së strukturave dhe institucioneve të ngarkuara për zbatimin e Planit të Veprimit Kundër Kultivimit dhe Trafikimit të Kanabisit; Çështjet e luftës kundër trafikimit të personave; Monitorimin e zbatimit të plan veprimit të miratuar “Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2023”; Ndjekjen dhe ecurinë e zbatimit të mekanizmave ligjor, për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor; Kontrollin dhe monitorimin e menaxhimit të mbetjeve, brenda territorit të qarkut, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore; Menaxhimin dhe përballimin e situatave emergjente në qark, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore; Marrjen e masave për zbatimin e “Paketës së sigurisë në shkolla”, Marrjen e masave emergjente mbrojtëse për parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga çdo dëmtim në pyje publike e private.

#### **IV.4.1. Task Forca Vendore Antikanabis**

*Në zbatim të Planit të veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit, me përfaqësues të Degëve Territoriale të të gjitha Institucioneve që janë të përfaqësuara në TFQ, si dhe përfaqësues të njësive të vetëqeverisjes vendore (mbi bazën e marrëveshjeve të bashkëpunimit) është ngritur dhe funksionon Task Forca Vendore “Për realizimin e koordinimit dhe bashkëveprimin efektiv të veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor dhe të këtyre institucioneve me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit”*

Nga ana e Prefektit, në përmbushje të misionit dhe ushtrimit të përgjegjësive, në cilësinë edhe të drejtuesit të Task Forcës Vendore;

a. Është zhvilluar takimi i Task Forcës Vendore Antikanabis, lidhur me realizimin e koordinimit dhe bashkëveprimin efektiv të veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor dhe të këtyre institucioneve me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për parandalimin (sensibilizimin dhe ndërgjegjësimin e komunitetit), goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit (Takim datë 9 Mars),

takim në të cilin përveç anëtarëve të Task Forcës kanë marrë pjesë edhe drejtues të institucioneve rajonale dhe të njësisve të vetëqeverisjes vendore, si dhe administratorë të Nj.A territori i të cilave është me rrisht në kultivimin e bimëve narkotike

b. Në takimet me drejtuesit e Degëve Territoriale dhe të njësisve të vetëqeverisjes vendore, të organizuara për çështje të tjera, janë trajtuar çështjet të cilat kanë të bëjnë me veprimet antikanabis (veçanërisht masat parandaluese) me objektivin e vetëm moskultivimin e kanabisit

c. Nga strukturat e policisë vendore, të njësisve të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve vendore, pjesë e Task Forcës vazhdojnë takimet sensibilizuese dhe ndërgjegjësuese në parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike

## 2. *Kontrollet e ushtruara dhe gjetjet e rezultuara*

Gjatë vitit nga strukturat e policisë vendore dhe strukturat e tjera e njësitë e vetëqeverisjes vendore (pjesë e Task Forcës Vendore Antikanabis) nga 20,825 kontrolle (nga të cilat nga strukturat e policisë vendore 17,998 kontrolle), të ushtruara me 1,934 grupe (nga të cilat 1,636 grupe nga strukturat e policisë vendore) në të cilat janë angazhuar 7,348 punonjës (duke kryer 64,835 ore shërbimi) dhe 1,731 automjete, **janë** evidentuar 142 raste të kultivimit të 200,689 bimë/fidan/kubik të dyshuara narkotike-canabis sativa, në 1,167 parcela e miniparcela dhe 41 ambiente të mbyllura (sera të përshtatura për kultivim, në pronë publike), nga të cilat 50 raste me 114,361 rrënjë, ose 57 % i përkasin territorit të bashkisë Shkodër; 25 raste me 44,910 rrënjë, ose 22.4 % territorit të bashkisë Malësi e Madhe; 51 raste me 37,915 rrënjë, ose 18.9 % territorit të bashkisë Vau i Dejës; 10 raste me 2,684 rrënjë, ose 1.3 % territorit të bashkisë Fushë Arrëz dhe 6 raste me 819 rrënjë, ose 0.4 % territorit të bashkisë Pukë; ku sipas njësisve të vetëqeverisjes vendore paraqiten:


**Për 142 rastet e evidentuar, nga të cilat janë zbuluar 48, ose rreth 34 %, janë proceduar penalisht (referuar në Prokurori) 101 persona, nga të cilët;**

- **88 autor (43 të arrestuar, 22 në kerkim dhe 23 ndiqen në gjendje të lirë);**

- **13 persona/shtetas (5 Kryetar fshati; 1 Drejtor/ing./inspektor pyjor, 5 punonjës OSSH, 1 punonjës ujësjellësi-specialist/lexues/hidraulik dhe 1 bujk-fermer), për veprën penale “Shpërdorim detyrë” “Moskallëzim krimi” (parashikuar nga neni 248 e 300 i Kodit Penal), të cilët ndiqen në gjendje të lirë**

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (ku janë evidentuar 102 raste të kultivimit të 70,496 rrënjë të bimëve narkotike), rezulton se janë evidentuar 40 raste (vepra penale) dhe 130,193 rrënjë/bimë narkotike më tepër (bimë narkotike të evidentuara dhe të asgjesuara)

**Numri i rasteve, parcelave dhe bimëve narkotike të gjetura dhe të asgjësuar gjatë viteve 2016-2023, në formë grafike paraqitet;**



Nga monitorimi dhe sipas informacionit të: Drejtorisë Vendore të Policisë, Nga ana e strukturave të policisë vendore;

Janë përgatitur hartat e kultivimit të bimëve narkotike për vitin 2023 në territorin e qarkut, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, duke përcaktuar zonat me risk të lartë (kryesisht zonat e thella malore), pas analizimit që i është bërë fenomenit të përhapjes gjatë viteve të kaluara.

U është bërë kërkesë për bashkëpunim njësive të vetëqeverisjes vendore (Bashkisë Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë, Fushë Arrëz), institucioneve vendore (Drejtorisë Rajonale OSSH Sh. A, Degës së Doganës, Administratës Rajonale të ZM, Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Shkodër, Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, Drejtorisë Vendore të ASHK Shkodër) dhe Prefektit të Qarkut

Sipas kalendarit të hartuar e miratuar nga DVP dhe Komisaritet e policisë (Nr.43 k, datë 22.02.2023 “Për zhvillimin e takimeve sensibilizuese, në kuadër të veprimtarisë për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike në qarkun Shkodër për vitin 2023”), janë zhvilluar 63 takime sensibilizuese, në të cilat janë angazhuar 211 punonjës policie (duke kryer 633 orë shërbimi) më 65 mjete (Brenda territorit të bashkisë Shkodër 28, Malësi e Madhe 14, Vau i Dejës 7, Pukë 8 dhe Fushë Arrëz 6) në institucionet vendore, përfshi institucionet arsimore publike e jopublike, në të cilat kanë marrë pjesë 1,796 persona, takime në të cilat është



përçar mesazhi i vendosmërisë së policisë së shtetit dhe të të gjitha strukturave shtetërore për të goditur dhe luftuar pa asnjë kompromis veprimtarinë kriminale të kultivimit të bimëve narkotike me qëllim nxjerrjen e qarkut Shkodër nga harta e kultivimit.

Zhvillimi i takimeve sensibilizuese është pasqyruar në mediat lokale

Nga strukturat e policisë të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, Komisariateve të Policisë Shkodër, Pukë, Malësi e Madhe, Vau Dejës dhe Stacionit të Policisë Fushë-Arrës, kanë vazhduar kontrollet në terren nga grupet e kontrollit të territorit, për identifikimin e serave, objekteve, ambienteve, vendeve, që mund të shfrytëzohen për kultivim të bimëve narkotike, si dhe personave të implikuar në këtë veprimtari kriminale, periudhë në të cilën janë kryer 17,998 kontrolle (në sera e minisera 1,519; magazina e objekte 590; ish objekte ushtarake 438; shtëpi të braktisura 437; stane e stalla 55; ambiente të hapura 14,827 dhe ish parcela në të cilat është konstatuar kultivim bimë narkotike gjatë viteve të fundit 132) të ushtruara me 1,636 grupe, në të cilat janë angazhuar 6,446 punonjës policie (duke kryer 52,632 ore shërbimi) dhe 1,576 automjete (mesatarisht 0.96 automjet/grup kontrolli); **janë evidentuar 142 raste të kultivimit të 200,689 bime/fidan/kubik të dyshuara bimë narkotike-cannabis sativa, në 1,167 parcela e miniparcela dhe 41 ambiente të mbyllura-sera e ambiente të tjera të përshtatura për kultivim)**

**Për 142 rastet e evidentuar, nga të cilat janë zbuluar 48, ose rreth 34 %, janë proceduar penalisht (referuar në Prokurori) 101 persona, nga të cilët;**

- **88 autor (43 të arrestuar, 22 në kerkim dhe 23 ndiqen në gjendje të lirë);**
- **13 persona/shtetas (5 Kryetar fshati; 1 Drejtor/ing./inspektor pyjor, 5 punonjës OSSH, 1 punonjës ujësjellësi-specialist/lexues/hidraulik dhe 1 bujk-fermer),** për veprën penale “*Shpërdorim detyrë*” “*Moskallëzim krimi*” (parashikuar nga neni 248 e 300 i Kodit Penal), të cilët ndiqen në gjendje të lirë

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar (ku janë evidentuar 102 raste të kultivimit të 70,496 rrënjë të bimëve narkotike), rezulton se janë evidentuar 40 raste (vepra penale) dhe 130,193 rrënjë/bimë narkotike më tepër (bimë narkotike të evidentuara dhe të asgjesuara)

#### **IV.4.2. Zbatimi i masave për çështjet e luftës kundër trafikimit të personave**

Janë zhvilluar takimet e Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave (I krijuar me Urdhër Nr. 6, datë 26.01.2017, të Kryeministrit “*Për Krijimin e Komitetit Rajonal të Luftës Kundër Trafikimit të Personave, në çdo Qark*”) dhe Tryezës Teknike (të ngritur me Urdhër Nr. 21, datë 02.03. 2023, të Prefektit/Kryetarit të Komitetit Rajonal), takime të cilat janë organizuar në bashkëpunim me MB (Zyrën e Koordinatorit Kombëtar)

Është hartuar e miratuar plan veprimi i luftës kundër trafikimit të personave për vitin 2023 i KRLKTP, si dhe plani i aktiviteteve sensibilizuese e ndërjegjësuere për parandalimin e trafikimit të personave që do të organizohen gjatë muajit Tetor (I nominuar “*Muaji i luftës kundër trafikimit të personave*”), plane të cilat janë hartuar mbi bazën e planeve të njësisive të vetëqeverisjes vendore, institucioneve vendore, organizatave të SHC-pjesë e KRLKTP

Nga ana e njësisive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve vendore, pjesë e KRLKTP, sipas planeve të miratuara, janë organizuar e zhvilluar gjatë gjithë vitit aktivitete sensibilizuese,

ndërgjegjësuere dhe informuese, lidhur me çështjet e trafikimit të personave dhe parandalimin e këtij fenomeni ((identifikimin, referimin, menaxhimin e rasteve), përfshi edhe aktivitetet e muajit Tetor (i nominuar si muaji i luftës kundër trafikimit të personave), me sloganin “*Nga Ndergjegjesimi ne veprim Bashkohuni ne luften kunder trafikimit!*”, ku nga KRLKTP, Institucionet Vendore dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore janë zhvilluar;

- Mbi 100 aktivitete sensibilizuese, ndërgjegjësuere dhe informuese, lidhur me trafikimin e personave dhe parandalimin e këtij fenomeni (përfshi takimet e organizuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, Zyrrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, Drejtoria Rajonale e Ofrimit të Formimit Profesional Publik, Drejtoria Vendore e Policisë e Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin, Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor, Organizata e Shoqata të ndryshme, etj.);

- sesione informuese me komunitetin, nxënës, mësues, psikologë, etj.
- orë të hapura, edukative në shkolla
- trajnime, tryeza të rumbullakëta;
- Shfaqje filma, dokumentar, video, etj. me subjekt rreth çështjeve të trafikimit të personave;

- emisione televizive në mediat lokale;
- javë solidariteti, në ndihmë të familjeve në vështirësi ekonomike
- ekspozita me punime të nxënësve të shkollave të mesme dhe 9-vjeçare, ne te gjitha shkollat brenda territorit të qarkut, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ekspozita, me punimet më të mira, në hollin e ndërtesës së Institucionit të Prefektit në mbyllje të aktiviteteve të muajit Tetor, ku u shpërndanë Çertifikata vlerësimi për nxënës dhe Çertifikata Pjesëmarrje për shkolla

Gjate vitit nga intervistimi dhe vlerësimi i situatës nga strukturat e bashkise Shkoder, Drejtorise Vendore të Policise eshte është identifikuar 1 rast VT (e mitur), e cila është sistemuar ne qëndrën e reabilitimit, për viktimat e Trafikimit në Tiranë dhe 2 raste VMT. Nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë janë referuar në prokurorinë e rrethit gjyqësor Shkodër 3 raste. Nga struktura e bashkisë Shkodër, është bërë menaxhimi i 14 rasteve të identifikuara gjatë vitit të kaluar, si dhe i rasteve të identifikuara gjatë vitit

Nga shërbimet e policisë kufitare dhe të migracionit janë prapësuar 66 persona në kufi (pa vizë hyrje dhe pa dokumenta të vlefshme). Janë kapur në kufi 413 shtetas të huaj nga vendet në konflikt 320 shtetas për herë të parë dhe 93 shtetas përsëritës), nga të cilët janë larguar vullnetarisht dhe një dërguar në qendren e mbyllur për të huaj 4 shtetas. Gjatë periudhës është ulur tendenca për dalje nga R. Sh e shtetasve shqiptar kryesisht mosha te reja qe kalojnë nëpërmjet PKK Muriqan e Hani i Hotit për te shkuar ne vendet e Evropës Perëndimore, me qëllim kërkesën për azil, kjo falë edhe masave dhe rritjes së kontrollit në PKK dhe kufirin e gjelbër. Ju është refuzuar dalja nëpërmjet PKK 197 shtetasve shqiptar, të cilët nuk kanë plotësuar kushtet ligjore, për të udhëtuar apo kanë shkelur rregullat e hyrjes e qëndrimit në vendet e BE

Nga ana e Shërbimit Social Shtetëror, gjatë periudhës, nuk janë evidentuar raste të VT/VMT. Janë identifikuar 111 fëmijë të komunitetit rom dhe egjiptian

Janë trajtuar me ndihmë ekonomike 4,487 familje në qark, nga të cilat 459 me kryefamiljar gra, 33 familje të komunitetit rom dhe egjiptian, Nga skema e ndihmës ekonomike trajtohen 14 viktima të dhunës në familje. Janë evidentuar 207 familje në vështirësi ekonomike dhe me probleme sociale, si dhe 3 persona të braktisur të cilët janë në proces për procedurat e sistemimit në shtëpi dhe të moshuarëve.

Kanë përfituar nga skema e PAK 5121 persona dhe kujdestari 1,402 persona, nga të cilët 98 persona të komunitetit rom dhe egjiptian

Janë identifikuar dhe evidentuar nga bashkia Shkodër 69 raste të fëmijëve të rrugës, ndërsa nr total i rasteve të menaxhuara për këtë periudhë është 94, për të cilat së bashku me familjet janë: Hartuar planet e ndërhyrjes për integrimin; Mbështetur me ndihma ushqimore, veshmbathje e medikamente për fëmijët, të cilët kanë patur probleme shëndetësore; Mbështetur me paketa (ushqimore, veshmbathje, higjeno-sanitare, etj.) familjet e fëmijëve rom/ egjiptian dhe familjet me vështirësi social-ekonomike; Mbështetur nga ana psiko-sociale, lehtësim dhe orientim për procedurat administrative, punësim, ndihmë ekonomike, etj. Numri i punëkërkuarve të papunë ka qenë gjithsej 4984 (femra 2770), nga të cilët të komunitetit rom dhe egjiptian 147 , emigrant të kthyer 22

Probleme, pengesa dhe vështirësi të evidentuara gjatë periudhës

Mungesa e bashkëpunimit të komunitetit;

- rom, për ndryshim vendbanimi, për të patur akses në shërbimet publike (strehim, ndihmë ekonomike, etj.)
- rom dhe egjiptian për tu angazhuar në integrimin e tyre social-ekonomik (përfshirja në kurse profesionale, punësim, edukim, etj.)

Fenomeni i shfrytëzimit të fëmijëve për lypje në rrugë, që është më prezent në bashkinë Shkodër, fenomen i cili shpesh nuk trajtohet me seriozitet dhe sipas kërkesave të përcaktuara ligjore nga institucionet e ngarkuara për mbrojtjen e fëmijëve. Edhe në rastet e të miturve të identifikuar si VMT duhet intensifikuar puna bashkëpunuese

Bashkëpunimi me policinë duhet të jetë më eficient që në momentin e identifikimit si dhe në trajtimin e rasteve të referuara në zbatim të nenit 124/b si dhe të procedurave për kërkesat për urdher të menjehershëm të mbrojtjes si dhe për procedurat për marrjen e masave të menjehershme të mbrojtjes të fëmijëve. Mungesa e ndërjegjësimin të qytetarve, përse i përket fenomenit të shfrytëzimit ekonomik (lypjes në rrugë) të fëmijëve dhe pasojave të këtij fenomeni, që megjithë fushatat ndërjegjësuese mbetet akoma shumë për tu bërë.

Mungesa e kapaciteteve infrastrukturore në Qendrën e Formimit Profesional Publik, të cilat ndikojnë në plotësimin e kërkesave të ndryshueshme të tregut të punës.

Mungesa e 1 qendre rezidenciale, ku mund të akomodohen VT/VMT ka sjellë e sjell vështirësi, lidhur me çështjet e luftës kundër trafikimit të personave, kjo e lidhur edhe pamundësinë e institucioneve për t'ju përgjigjur kërkesave për akomodim. Shpeshherë për rastet e dhunës në

familje, në mungesë të qendrës duhet të negociohet dhe të akomodohen brenda ditës në familje

#### Sugjerime dhe rekomandime

a. Të rritet niveli i bashkëpunimit i të gjitha institucioneve në luftën kundër trafikimit të personave, përfshi institucionet që kryejnë veprimtari në pikat e kalimit të kufirit, për mbikëqyrjen e shtetasve të cilëve u është refuzuar azili në vendet BE. Në mënyrë të veçantë të bashkëpunohet për informimin dhe ndërgjegjësimin e shtetasve për detyrimet, lidhur me lëvizjen e lirë, pamundësinë e plotësimit të kërkesave për azil, duke qenë se Shqipëria është vend i sigurt, si dhe nga ana e Zyrate Vendore Arsimore (në të gjithë sistemin e arsimit parauniversitar) informimin, lidhur me nxënësit që nuk vazhdojnë procesin mësimor, e kanë ndërprerë, nuk frekuentojnë rregullisht, duke specifikuar nxënësit e komunitetit rom dhe egjiptian, nxënësit e familjeve me kryefamiljar gra, nxënësit jetim, etj.

b. Të programohen dhe të zhvillohen takime të vazhdueshme informuese në

c. shkolla mbi çështjet e luftës kundër trafikimit të personave nga ZVAP dhe shkollat në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore (punonjësit social dhe të qendrave komunitare) dhe strukturat vendore të policisë, si dhe të kryhen trajnime të punonjësve/specialistëve përgjegjës në institucionet vendore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, lidhur me çështjet e trafikimit të personave (menyrat dhe teknikat e intervistimit të personave të dyshuar/rrezikuar, referimi, menaxhimi i rasteve dhe raportimi)

d. Të ketë një vëmendje të shtuar, duke përqendruar veprimtarinë, në eliminimin e mungesës së referimeve të rasteve të evidentuara (si pasojë e mosnjohjes së fenomenit apo mos marrjes në konsideratë të manifestimeve të ndryshme të problematikave që nxënësit paraqesin në shkolle), si dhe në përgjegjësitë ligjore me të cilat ngarkohet personi përgjegjës që tregon anashkalim e neglizhim të këtyre rasteve

e. Të krijohen mundësi, për ofrimin dhe zhvillimin e kurseve profesionale, në përshtatje me kërkesat e tregut të punës, me qëllim punësimin e personave në përfundim të këtyre kurseve dhe plotësimin e kërkesave të bizneseve të ndryshme

f. Të krijohen mundësi, për zhvillimin e praktikave profesionale pranë subjekteve private, për rritjen e cilësisë së mësimdhënies

g. Të merren masa për përfshirjen e shtetasve vulnerabel (pas identifikimit) dhe të personave në skemën e ndihmës ekonomike, në formim profesional

h. Të merren masa për përshtetimin e procedurave të ndërtimit të qendres multifunksionale për qarkun (*e programua për tu ndërtuar në veri; PKV, Anesksi 1, Objektiv i Specifik 3.1, Veprimtaria 3.1.7*), për riintegrimin dhe mbështetjen e grupeve vulnerabel të shoqërisë, të riskuar nga trafikimi, përfshirë VT/VMT, si dhe për të ofruar asistencë dhe shërbime shëndetësore, ekonomike, formim profesional dhe ngritje kapacitetesh për këto grupe vulnerabel

#### **IV.5. Masat e marra për përballimin e situatave nga emergjencat**

Në zbatim të ligjit nr.45/2019, “Për Mbrojtjen Civile”, Ligjit nr.107/2016, “Për Prefektin, si dhe në vijim të detyrave të deleguara nga MM, dhe AKMC, gjatë vitit 2023, puna dhe veprimtaria e sektorit të PPECK është përqendruar në planifikimin e situatave të pritshme emergjente (Është hartuar plani vjetor i punës; Plani i Inspektimit/Monitorimit; plani i gadishmërisë me skenar-

përmbytjet, izolimin nga dëbora dhe zjarret; Abdetimi i planit të përballimit të EC).

#### **Gjate muajit Janar 2023,**

- Jane percaktuar objektivat dhe synimet per vitin 2023,
- Është hartuar nga sektori Plani i Punës nr. 126 prot., datë 10.01.2023.dhe plani mujor,
- Jane abdetuar planet e Mbrojtjes Civile dhe planet e gadishmerise me skenar permbytjet dhe izolimin nga Debora.
- Eshte hartuar Plani I Monitorim.Inspektimit per vitin 2023.
- Gjatë ketij muaji jemi ballafaquar me reshjet e debores, shiut dhe ngricat, per te cilen është organizuar mbledhja KMCQ, me datë 17.01.2023 me tematikë “Mbi problematikat që kanë shkaktuar reshjet e shiut në qarkun Shkodër” I cili ka analizur situaten dhe ka deleguar urdherin perkates, planin e masave per miremenaxhimin e situates.
- Gjate ketij Muaji janë përcjellur pranë AKMC kërkesat e bashkive për mbështetje me bazë dhe pako ushqimore te cilat kanë shkaktuar probleme në zonën e nën Shkodrës nga ku kemi patur rreth 1400 HA nën ujë dhe rreth 95 banesa me prezencë të ujit në oborre në NJAD Ana e Malit.
- Me grupe pune te ngritur nga Inst.Prefektit nen drejtimin e Prefektes ne rolin e Kr.KMCQ, jane planifikuar dhe kryer inspektime në tërren në bashkinë Shkodër për të monitoruar situatën hidrike si pasojë e reshjeve të rëna.
- **Me datë 19.01.2023 është organizuar mbledhja e dyte e KMC Qarku Shkodër me tematikë “Impakti i krijuar në zonat e përmblyura”.ku u percaktuan prioritete e mbeshtetjes dhe te nderhyrjes per kthimin ne normalitet te situates ne zonene e impaktit.**

#### **Gjatë muajit Shkurt.**

- Sektori PPECK ka bashkëpunuar me bashkitë e qarkut Shkodër në kuadër të indentifikimit të subjekteve private që do të përfshihen në infrastrukturën e paralajmërimit të hershëm, monitorimin, njoftimit dhe alarmit, si dhe është hartuar lista e burimeve njerëzore dhe e kapaciteteve logjistike për institucionet që janë pjesë e KMCQ.
- Eshte kordinuar puna me bashkite per normilazimim e situates se krijuar nga permbytjet

#### **Gjate Muajit Mars- Muajit Prill**

- Nga sektori PPECK ka filluar përgatitjen e zhvillimit të mbledhjes së rradhes të KMCQ me tematike “Përballimin e situatës së zjarreve në pyje dhe kullota në prag të sezonit veror, me qellim, Monitorimin, vrojtimin, organizimin e operacioneve për shuarjen e zjarreve në pyje dhe kullota”.

Në perfundim te takimit u pergatiten dhe u deleguan per zbatim aktet e mëposhtme:

- Plani Parandalimit, nr. 254/5 prot., datë 03.04.2023
- Plani i Masave, nr. 254/4 prot., datë 03.04.2023
- Skema e komunikimit, shkëmbimi i informacionit për menaxhimin dhe shuarjen e zjarreve, nr. 254/6 prot., datë 03.04.2023
- Urdhër, nr. 254/3 prot., datë 03.04.2023

Në lidhje me veprimtarinë e mësipërme është informuar Ministria e Mbrojtjes dhe AKMC nëpërmjet shkresës, nr. 254/9 prot., datë 07.04.2023.

#### **Gjatë muajit Korrik.**

- Në zbatim të planit monitorimit, nga Sektori PPECK i Institucionit të Prefektit Qarkut Shkodër, janë organizuar takimet në të 5 bashkitë e Qarkut për të analizuar nga afër problematikat e ndryshme si kapacitetet dhe burimet njerëzore që disponojnë secila bashki, masat e marra për organizimin e vrojtimit dhe të paralajmerimit të hershëm dhe mundësitë aktuale të reagimit të menjëhershëm për organizimin e operacioneve për shuarjen e zjarreve.
- Takimet u organizuan, me datat e mëposhtme:  
Në bashkinë Shkodër me datë 21 Korrik.2023.  
Në bashkinë Malësi e Madhe me datë 17 Korrik.2023.  
Datë 24 Korrik 2023 me përfaqësues të Bashkisë Pukë dhe Fushë Arrëz, takimi i organizuar në ambientet e bashkisë Pukë.  
Në bashkinë Vau Dejës me datë 25 Korrik 2023.
- Çdo javë është hartuar informacioni në lidhje me rastet e zjarrit në të gjithë bashkitë e territorit të qarkut sipas formatit të kërkuar nga Ministria e Brendshme. ç’do muaji komunikohet ç’do ditë me sektorët MC të bashkive të qarkut si dhe me strukturat e tjera të KMCQ, është informuar sistematikisht edhe AKMC  
**Periodha Prill-Tetor 2023** nga Sektori është monitoruar dhe inspektuar në terren, duke koordinuar operacionet e shuarjes së zjarreve në të gjithë territorin e Qarkut.  
**Me datë 20.07.2023 është organizuar takimi i radhes i KMCQ** ku u diskutua mbi situatën e zjarreve, për masat e marra për rritjen e evicencës së reagimit në kohë reale. Ndërgjegjësimi i komunitetit për kujdes të shtuar për tu mos u bërë shkak në përhapjen e zjarreve.  
**Gjate Muajit Tetor.**  
Eshtë mbledhur KMCQ “ Për të analizuar zjarret dhe masat që do të merren për emergjencat sezonale masat mbrojtëse dhe parandaluese nga përmblytjet, vërshimin e përrenjve dhe izolimin nga dëbora“ Vjeshtë – Dimër 2023 – 2024”.  
Në kuadër të këtij takimi është hartuar plani i masave nr.603/19 prot., datë 09.10.2023 “ Për përballimin e situatave emergjente sezonale Vjeshtë – Dimër për periudhën 2023 – 2024 në territorin e qarkut Shkodër”.  
Është hartuar urdhëri nr. 65 ( nr. 603/18 prot ), datë 09.10.2023 i KMCQ “Për përballimin e situatave emergjente sezonale Vjeshtë – Dimër për periudhën 2023 – 2024, në territorin e qarkut Shkodër”.  
Numri i zjarreve në nivel qarku për periudhën **Janar – Dhjetor 2023 është 649 raste** të raportuara nga drejtoria/sectorët MZSH dhe sektoret MC të bashkive të qarkut Shkodër, i ndarë sipas sipas bashkive është si më poshtë:

1. Bashkia Shkodër 342 raste zjarresh.
2. Bashkia Malësi e Madhe 132 raste zjarresh.
3. Bashkia Vau Dejës 153 raste zjarresh.
4. Bashkia Puke 10 raste zjarresh.
5. Bashkia Fushe Arrëz 12 raste zjarresh.
6. Nga struktura ADZM në Zonat e Mbrojtura është 5 raste.

**Viti 2023, Konsiderohet si viti me I sukseseshem ne parandalimin dhe shuarjen e zjarrev ne krahasim me vitet e tjera dhe me Prefekturat e tjera, pasi goditja parandaluese e strukturave**

te DVP ka qene efikase, ndergjegjesimi ka qene efikas dhe nderhyrja e menjehershem e strukturave reaguese qe nga niveli local ka qe ne momentin e shfaqes se zjarrit ka qene efikas, pasi nuk eshte kerkuar asnje ndihme apo mbeshtetje nga strukturat qendrore apo futurimet nga ajri

#### 7. Në kuadër të projektit “Katastrofat nuk njohin kufinj”.

- Me datë 11.10.2023 deri 13.10.2023, specialistët e sektorit PPECK kanë marrë pjesë në takimin me temë “Forecasting and Early Earning System” dhe në takimin me temë “Praktikat më të mira të koordinimit, mbrojtjes dhe shpëtimit në rastet e përmytjeve”
- Me datë 21.12.2023 Prefektura e Qarkut Shkodër në bashkëpunim me MZSH Shkodër dhe nxënësit është organizuar fushatë ndergjegjesuese mbi reziqet natyrore në shkollën 9-vjecare “Salo Halili”.ku janë realizuar demonstrime praktike në rastet kur ka rrezikshmëri zjarresh.
- Gjate muajit Dhjetor jane ofruar nga projekti disa sete veshjesh dhe paisjesh te cilat do ti jepen strukturave te ushtrise, MZSH dhe FNSH per nderhyrje ne situata emergjente permbytjesh dhe zjarresh.

#### 8. Ne Muajin Nendor.

- Me datë 01.11.2023 dhe 02.11.2023 janë realizuar një seri inspektimesh në territorin e bashkisë Shkodër në lidhje me pergatitjen dhe hartimin e planeve, verifikimin e funksionimit te drejtorive dhe sektorebve te MC ne nivel Bashkie.
- Me datë 09.11.2023 me drejtues të AKMC dhe përfaqësues të njërive të vetqeverisjes vendore, në kuadër të projektit RESEAL-UNDP u diskutua për hartimin dhe implementimin e 3 dokumentave strategjik në nivel vendor.
- Me datë 15.11.2023 nga Sektori është organizuar një tryezë e Rrumbullakety me perfaqesues jo vetëm të KMCQ Shkodër por edhe te institucioeve te tjera jo anetare te KMCQ, si Universiteti i Shkodres, etj me qellimi e diskutimit te 3 dokumentave strategjike qe jane Plani Lokal per MC, Plani i Zvogelimit te rriskut ne nivel Lokla, dhe strategjia lokave e parandalimit te rriskut ne nivel Lokal, në të cilën u diskutuaan problematikat dhe u lane detyra me afater për hartimin e planit vendor të mbrojtjes civile, startegjitë vendore për fatkeqësitë natyrore dhe zvogëlimin e riskut, dokumente strategjike që duhet të hartohen nga 5 bashkitë e qarkut, mbi bazen e nje urdheri te deleguar nga Prefekti per kete qellim.
- Me datë 22.11.2023 në bashkinë Malësinë e Madhe si pasojë e reshjeve të dendura të shiut ka shkaktuar probleme në NjA Qëndër Koplik, NjA Kastrat dhe në qytetin e Koplikut. Ka patur 26 shtëpi me prezencë uji, janë dëmtuar 23 mure shtëpish rrethuese, janë dëmtuar 8 biznese dhe ka patur 5 raste dëmtimesh në produkte bujqësore dhe eterovajore.

#### 9. Problematikat :

- Mos organizmi dhe eficaenca e strukturave të emergjencave civile në nivel bashkie.
- Mos hartimi I dokumentave kryesore qe parashikon ligji “Per mbrojtjen civile” nga bashkite.
- Mungesa e planifikimit dhe përdorimit të fondeve nga ana e bashkive (4% i emergjencave civile) si detyrim ligjor, për të rritur kapacitetet tekniko-operacionale, sidomos për automjete, paisje dhe mjet teknike zjarrfikese.
- Mosraportimi në kohë reale I cdo rasti te fatkeqesishe natyrore.
- Pamjaftueshmëria logjistike dhe burimeve njerëzore e teknike nga strukturat vendore të MZSH për përballimin e situatave të zjarreve në pyje.

- Angazhimi i pamjaftueshëm i vullnetarëve dhe i komunitetit për ti angazhuar ne situatë emergjente dhe mangësi nga bashkitë për pajisjen me mjete të nevojshme për ta.
- Mungesa e vrojtuesve për mbulimin dhe monitorimin e zones së përgjegjësisë.
- Mosreagimi I menjëhershëm që në momentin e shfaqës së fatkeqesise

## **V. MARRËDHËNIET E PREFEKTIT ME NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE**

Marrëdhëniet e Prefektit të qarkut me njësitë e vetëqeverisjes vendore (Këshillin e qarkut dhe bashkitë), të përcaktuara edhe në Ligjin “Për Prefektin e qarkut” dhe “Për vetëqeverisjen vendore”, kanë qenë marrëdhënie konsultimi dhe bashkëpunimi për zgjidhjen e problemeve të përbashkëta dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.

Njesite e veteqeverisjes vendore, janë asistuar me ndihmën e nevojshme juridike në mënyrë goftë verbalisht, apo edhe me dhënie Udhëzimesh, Rekomandimesh, deri edhe në takime lidhur me problemet që kanë organet drejtuese në interpretimin dhe zbatimin akteve ligjore e nenligjore.

Është bashkëpunuar për ushtrimin e funksioneve të transferuara nga Ministrinë dhe Institucionet qendrore tek njësite e vetëqeverisjes vendore, duke mbikqyrur e monitoruar përdorimin e fondeve të transferuara nga buxheti (në formën e transfertës sektoriale) për kryerjen e ketyre funksioneve. Po kështu është bashkëpunuar mbi zbatimin e detyrimeve ligjore në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, përfshirë edhe shërbimin e furnizimit me ujë të konsumatorëve dhe largimin e ujrave të ndotura

### **V.1. Kyerja e funksioneve të transferuara njësive të vetëqeverisjes vendore**

Në përmbushje të misionit dhe përgjegjësisë, mbështetur në Ligjin “Për Prefektin”, Vendimet e KM dhe Udhëzimeve në zbatim të tyre, është bashkërenduar puna me njësitë e vetëqeverisjes vendore (bashkitë) për ushtrimin nga ana e tyre, të funksioneve të transferuara nga institucionet qendrore, duke mbikqyrur dhe monitoruar fondet e transferuara (transferten e pakushtëzuar sektoriale) per kryerjen e ketyre funksioneve, për:

#### **1.1. Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin**

Janë kryer shpenzime me vlerë 126,961 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 36,785 mijë lekë; Shkoder 43,678 mijë lekë; Vau i Dejës 14,493 mijë lekë; Pukë 15,155 mijë lekë dhe Fushë Arëz 16,850 mijë lekë), nga 157,781 mijë lekë të programuara (fonde të vitit 2023 dhe të trashëguara) ose 80.5 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 30,820 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2024



### **1.2. Sistemin e ujitjes dhe kullimit**

Janë kryer shpenzime me vlerë 66,278 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 16,599 mijë lekë; Shkoder 31,705 mijë lekë; Vau i Dejës 13,240 mijë lekë; Pukë 1,587 mijë lekë dhe Fushë Arëz 3,147 mijë lekë), nga 95,421 mijë lekë të programuara (fonde të vitit 2023 dhe të trashëguara) ose 70 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 29,143 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2024

### **1.3. Pyjet dhe kullotat publike**

Janë kryer shpenzime me vlerë 69,036 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 17,300 mijë lekë; Shkoder 13,970 mijë lekë; Vau i Dejës 5,184 mijë lekë; Pukë 12,596 mijë lekë dhe Fushë Arëz 19,986 mijë lekë), nga 92,737 mijë lekë të programuara (fonde të vitit 2023 dhe të trashëguara) ose 74.4 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 23,701 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2024

### **1.4. Rrjetin e rrugëve rurale**

Janë kryer shpenzime me fondet nga transfertat sektoriale me vlerë 73,004 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 14,000 mijë lekë; Shkoder 24,889 mijë lekë; Vau i Dejës 6,003 mijë lekë; Pukë 10,169 mijë lekë dhe Fushë Arëz 17,943 mijë lekë), nga 81,147 mijë lekë të programuara (fonde të vitit 2022 dhe të trashëguara) ose 90 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 8,143 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2024

### **1.5. Menaxhimi i Mbetjeve**

Janë kryer shpenzime, me fondet e buxhetit për menaxhimin e mbetjeve, me vlerë 22,778 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 5,700 mijë lekë; Shkoder 17,078 mijë lekë), nga 25,528 mijë lekë të programuara (fonde të programuara nga buxheti për bashkitë në formën e transfertës pakushtëzuar sektoriale, për menaxhimin e mbetjeve), ose 89.2 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 2,750 mijë lekë, shumë e cila trashëgohet për tu përdorur në vitin 2024

### **1.6. Arsimi parashkollor, arsimi parauniversitar, konviktet e arsimit parauniversitar**

Janë kryer shpenzime me vlerë 540,424 mijë lekë (Bashkia M.Madhe 80,836 mijë lekë; Shkoder 294,625 mijë lekë; Vau i Dejës 56,988 mijë lekë; Pukë 68,843 mijë lekë dhe Fushë Arëz 39,132 mijë lekë), nga 588,961 mijë lekë të programuara (fonde të vitit 2023 dhe të trashëguara) ose 91.8 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 48,537 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2024

### **1.7. Mbrojtja sociale**

Janë kryer shpenzime me vlerë 143,098 mijë lekë (Bashkia Shkoder 36,917 mijë lekë dhe Bashkia Puke 106,181 mijë lekë), nga 147,576 mijë lekë të programuara (fonde të vitit 2022 dhe të trashëguara) ose 97 % e shpenzimeve të programuara, me një mospërdorim prej 4,478 mijë lekë, shumë e cila është trashëguar për tu përdorur gjatë vitit 2024

Pasqyra, lidhur me planifikimin dhe përdorimin e fondeve për ushtrimin e funksioneve të transferuara (transfera sektoriale), përmbledhëse dhe sipas bashkive

**Përmbledhëse**

*Në mijë lekë*

Nr.	Bashkia	Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për buxhet. familjare e individ		Investime		Shuma	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
1	M.Madhe	119,286	118,444	20,413	20,257	22,759	21,889	1,524	633	20,358	9,998	184,341	171,221
2	Shkoder	294,256	259,798	45,390	43,053	154,206	114,737	42,166	38,438	14,556	6,835	550,574	462,862
3	Vau Dejës	85,143	85,143	14,305	14,305	19,021	11,681	0	0	2,284	0	120,753	111,129
4	Pukë	90,425	82,221	15,216	13,886	27,247	9,015	107,700	106,314	16,270	3,095	26,004	15,155
5	F. Arrëz	95,734	74,529	15,205	13,011	18,866	8,995	244	244	900	280	130,949	97,059
	<b>Qarkut</b>	<b>684,844</b>	<b>513,535</b>	<b>110,529</b>	<b>104,512</b>	<b>242,099</b>	<b>166,317</b>	<b>151,634</b>	<b>145,629</b>	<b>54,548</b>	<b>20,208</b>	<b>1,012,621</b>	<b>857,426</b>

**1. Bashkia Malësi e Madhe**

*Në mijë lekë*

Funksioni	Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për buxh familj. e individ		Investime		Shuma				
	Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt		
Infrastr. Ujitj. dhe Kullimit	1	4240		6,008	6,008	1,010	1,009	9,719	9,582	100	-	7,500	0	24,337	16,599
Administrimi i pyjeve	1	4260		12,721	12,721	2,254	2,254	2,502	2,111	200	94	2,217	120	19,894	17,300
Rrugë Rurale	1	4520		11,929	11,929	2,071	2,071	0	0	335	-	0	0	14,335	14,000
Menaxhimi i Mbetjeve	1	5100		0	0	-	-	5,700	5,700	-	-	0	0	5,700	5,700
Arsimi bazë (përf.parash.)	1	9120		59,504	59,504	10,200	10,200	0	0	415	415	0	0	70,119	70,119
Arsimi mesëm, Konvikti	1	9230		8,674	8,674	1,449	1,449	189	189	224	124	469	281	11,005	10,717
Shërbimi i MZSh-së	1	3280		20,450	19,607	3,430	3,274	4,650	4,307	250	0	10,173	9,597	38,952	36,785
<b>Totali</b>				<b>119,286</b>	<b>118,444</b>	<b>20,413</b>	<b>20,257</b>	<b>22,759</b>	<b>21,889</b>	<b>1,524</b>	<b>633</b>	<b>20,358</b>	<b>9,998</b>	<b>184,341</b>	<b>171,221</b>

2. Bashkia Shkodër

*Në mijë lekë*

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për buxhet famil.individ e të brendshme		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Menaxhim Infrastr. Ujitjes dhe Kullimit	1	4240	13,395	9,615	2,344	1,814	27,954	19,419	-	-	857	857	44,550	31,705
Administrimi i pyjeve	1	4260	14,263	9,228	2,044	1,506	3,120	2,293	-	-	1,082	943	20,509	13,970
Rrugë rurale	1	4520	-	-	-	-	26,350	24,889	-	-	-	-	26,350	24,889
Menaxhimi i Mbetjeve	1	5100	-	-	-	-	19,828	17,078	-	-	-	-	19,828	17,078
Arsimi bazë (parashkollor)	1	9120	187,677	170,411	28,610	28,043	-	-	1,308	1,198	1,669	1,669	219,264	201,321
Arsimi i mesëm (përgjith.)	1	9230	41,657	36,741	6,548	6,197	64,890	46,677	366	323	8,649	3,366	122,110	93,304
Përkujdesi social	1	10430	-	-	-	-	-	-	40,492	36,917	-	-	40,492	36,917
Shërbimi i MZSh-së dhe MC	1	3280	37,264	33,803	5,844	5,493	12,064	4,382	-	-	2,299	-	57,471	43,678
<b>Totali</b>			<b>294,256</b>	<b>259,798</b>	<b>45,390</b>	<b>43,053</b>	<b>154,206</b>	<b>114,737</b>	<b>42,166</b>	<b>38,438</b>	<b>14,556</b>	<b>6,835</b>	<b>550,574</b>	<b>462,862</b>

**3. Bashkia Vau i Dejës**

*Në mijë lekë*

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për buxhet.familjar e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Infastr. Ujitjes dhe Kullimit	1	4240	6,547	6,547	1,095	1,095	5,598	5,598			2,284		13,240	13,240
Administrimi i pyjeve	1	4260	4,263	4,263	723	723	299	199					7,568	5,184
Rrugë rurale	1	4520	4,143	4,143	710	710	1,454	1,151					6,306	6,003
Menaxhimi i Mbetjeve	1	5100					2,200						2,200	0
Arsimi bazë (parashkollor)	1	9120	38,659	38,659	6,501	6,501							45,160	45,160
Arsimi i mesëm (përgjith.)	1	9230	2,410	2,410	149	149							2,559	2,559
Arsimi (konviktet)	1	9240	7,722	7,722	1,548	1,548							9,269	9,269
Shërbimi i MZSh-së dhe MC	1	3280	12,414	12,414	2,079	2,079							14,493	14,493
Administrimi i Qend.Sociale	1	10430	8,986	8,986	1,501	1,501	9,471	4,733					19,958	15,220
<b>Totali</b>			<b>85,143</b>	<b>85,143</b>	<b>14,305</b>	<b>14,305</b>	<b>19,021</b>	<b>11,681</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>2,284</b>	<b>0</b>	<b>120,753</b>	<b>111,129</b>

4. **Bashkia Pukë**

*Në mijë lekë*

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për buxhet.familjare e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Infastr. Ujitjes dhe Kullimit	1	4240	852	798	166	130	3,889	3	0	0	2,552	656	7,459	1,587
Administrimi i pyjeve	1	4260	10,708	9,818	1,824	1,630	3,834	802	49	49	1,676	297	18,091	12,596
Rrugët rurale	1	4520	6,648	6,648	1,291	1,291	300	299			2,271	1,931	10,510	10,169
Arsimi bazë (përf. parash.)	1	9120	42,879	37,700	7,033	6,291	5,108	2,793	84	84	2,200	135	57,304	47,003
Arsimi i mesëm (përgjith.)	1	9230	7,563	7,086	1,279	1,179	2,248	830	0	0	200	76	11,290	9,171
Arsimi (konvikti Pukë)	1	9240	9,121	8,306	1,416	1,403	6,308	2,960			2,271	0	19,116	12,669
Mbrojtje sociale	1	10430	0	0	0	0	0	0	107,084	106,81	0	0	107,084	106,181
Shërbimi i MZSh-së	1	3280	12,654	11,865	2,207	1,962	5,560	1,328	483	0	5,100	0	26,004	15,155
<b>Totali</b>			<b>90,425</b>	<b>82,221</b>	<b>15,216</b>	<b>13,886</b>	<b>27,247</b>	<b>9,015</b>	<b>107,700</b>	<b>106,314</b>	<b>16,270</b>	<b>3,095</b>	<b>256,858</b>	<b>214,531</b>

**5. Bashia Fushë Arëz**

*Në mijë lekë*

Funksioni			Paga		Kontribut sig.shoq.shënd.		Shpenzime për mallra e shërbime		Transferime për buxhet.familj. e individ		Investime		Shuma	
Emërtimi (Lloji)	Kap.	Progr.	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
Infrastr. Ujit dhe Kullimit	1	4240	915	773	209	169	5,711	2,205					6,835	3,147
Administrimi i pyjeve	1	4260	18,453	15,331	2,925	2,636	4,397	1,738			900	280	26,675	19,986
Rrugët rurale	1	4520	14,936	13,318	2,970	2,536	5,740	2,089					23,646	17,943
Arsimi bazë(përf. parash.)	1	9120	41,581	28,833	5,609	4,776			244	244			47,434	33,852
Arsmi i mesëm	1	9230	4,622	4,452	876	828							5,498	5,280
Shërbimi i MZSh-së	1	3280	15,227	11,822	2,616	2,066	3,018	2,962					20,861	16,850
<b>Totali</b>			<b>95,734</b>	<b>74,529</b>	<b>15,205</b>	<b>13,011</b>	<b>18,866</b>	<b>8,995</b>	<b>244</b>	<b>244</b>	<b>900</b>	<b>280</b>	<b>130,949</b>	<b>97,059</b>

## V.2. PER VERIFIKIMIN E LIGJSHMERISE SE VENDIMEVE, URDRHAVE DHE URDBERESAVE ME KARAKTER NORMATIV TE ORGANEVE TE VETEQEVERISJES VENDORE 2023

Pranë Institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, në sekretari-arkivin gjatë vitit 2023, nga 6 njësi të qeverisjes vendore- 5 bashki dhe Këshilli i Qarkut Shkodër si njësi e dytë e qeverisjes vendore-, janë depozituar gjithsej **346** akte, nga të cilat **321** akte normative kanë qenë në përputhshmëri ligjore referuar funksioneve vendore, ndërsa për **25** akte nuk është lejuar procedim i mëtejshëm sipas argumentave ligjor.

Të gjitha aktet janë shqyrtuar sipas akteve ligjore dhe nënligjore specifike referuar Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175, datë 9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut” si dhe aneksi I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”,

Spektori juridik gjatë vitit 2023 është ndeshur me vendimarrje si buxhetet vendore të cilat paraqesin detyrim analizimin e elementeve buxhetore, si një dokument me karakter të plotë financiar dhe i rëndësishëm për gjithë territorin e bashkisë respektive.

Vendimeve të miratuara nga organi kolegjal me objekt rishpërndarjen e fondeve buxhetore, si kërkesë e ligjeve financiare është kërkuar respektimi i qartë i qëllimit dhe arsyeja e transferimit të këtyre fondeve në respekt të parimeve të funksionimit të sistemit buxhetor, atij të transparencës, parashikueshmërisë, unitetit dhe universalitetit në menaxhimin e sistemit buxhetor, respektimit rigoroz të destinacionit të transfertave specifike, edhe pse jemi ndeshur hera herës me oponencë, veçanërisht në përdorimin e fondit rezervë/kontigjencë, i cili ky i fundit ka një natyrë të veçantë përdorimi në buxhetin vjetor të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave.

Jemi ndeshur me fondin e kushtëzuar në zbatim të ligjit nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile” në një program buxhetor të ri. Tashmë është risi për shkak se dëmet e vlerësuara duhet përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësia, nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile. Në rast se bashkitë nuk kanë fonde të mjaftueshme për kompensimin, atëherë i planifikojnë ato për vitin pasardhës, deri në masën e kompensimit të subjekteve të dëmtuara. Përdorimi i fondeve sipas VKM Nr. 414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”.

Sistemi fiskal i bashkive ka rëndësi për qeverisjen vendore si burimi buxhetor i rëndësishëm për bashkitë nëse përdoren me efektivitet nga vetë bashkitë mënyrat e vjeljes.

Një gjë me risk është në rastet kur organi kolegjal nuk respekton zhvillimin e seancave të këshillimit me publikun parashikuar në nenin 18 të ligjit nr.139/2015 dhe ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin & konsultimin publik”.

Praktikat e sjella nga NJQV për dhënie në përdorim të pronës publike, në mungesë të çertifikatës së pronësisë i është kërkuar për shqyrtim dhe analizim të mëtejshëm statusi juridik nga ASHK-ja, sipas *Kreut II, neni 4, pika 1/b* e Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175, datë 9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, një gjë shumë pozitive pasi mborn pronën publike.

Këtë vit jemi ndeshur me trajtimin e vendimeve të këshillave bashkiak me objekt policinë bashkiake sipas ligjit të ri Nr. 89/2022 “Për Policinë Bashkiake”, apo rastet e trajtuara sipas VKM Nr.328/2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” apo rastet sipas VKM Nr. 326/2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”.

I kushtohet rëndësi e veçantë bashkëpunimit ndër-institucional sipas VKM Nr.864/2014 “Për

procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore” siç janë rastet e bashkëpunimit me Zyrën e Administrimit të Basenit Ujor Drin Bunë për vendimet që trajtohen sipas ligjit Nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.

Njësitë asistohen vazhdimisht me ndihmë juridike verbale apo edhe me dhënie Udhëzimesh, Rekomandimesh, deri edhe në takime lidhur me problemet që kanë pasur organet e pushtetit vendor në me qëllim shmangien e interpretimit keq të ligjit për t’i dhënë rrugë zhvillimit vendor, për të qenë sa më afër qytetarit në respekt të parimit të subsidiaritetit.

#### **PROCESI I VERIFIKIMIT NË VEND**

Spektori juridik gjatë vitit 2023 është kryer procesi i verifikimit në të gjitha NJQV sipas Urdhërit të Prefektit.

Procesi i verifikimit në vend i ndihmon të gjitha palët për të korigjuar gabimet qoftë në terminologji, qoftë kur keqinterpretohen kompetencat ligjore, e cila mund të vijë për shkak se jo çdo akt është azhornuar plotësisht.

#### **PROCESET GJYQËSORE**

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016, dt 2.10.2016 “Për Prefektin”, ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, vazhdon të jetë pjesë e proceseve gjyqësore, kryesisht si palë e tretë.

#### **VIT ZGJEDHOR**

Viti 2023 ka qenë vit zgjedhor, të cilat u zhvilluan me datë 14 maj 2023. Referuar ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 46, është përcaktuar numri i anëtarëve të këshillave për çdo bashki të Qarkut Shkodër. Detyra tjetër kryesore e Prefektit në zbatim të ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i RSH”, i ndryshuar sipas nenit 94 është propozimi pranë KQZ-së (si organ vendimarrës) e listës së plotë të objekteve brenda territorit të qarkut për vendet e numërimit të votave që përmbushin kushtet referuar nenit 93 pika 1 & 2 e Kodit Zgjedhor.

Pas shpalljes së rezultateve zgjedhore dhe ezaurimit të afateve të ankimimit ka vijuar konstituimi i këshillave bashkiak të qarkut Shkodër sipas tabelës së mëposhtme.

### **V.3. Bashkëpunimi me njësitë e vetëqeverisjes vendore për rritjen e performancës së të zgjedhurve vendor**

Është bashkëpunuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore në ushtrimin e funksioneve



dhe kompetencave të tyre ligjore, si dhe rritjen e performancës së organeve të tyre. Njësitë të vetëqeverisjes vendore u është kërkuar zbatimi i detyrimit ligjore (neni 15 i Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”) për publikimin e akteve; U është rikujtuar marrja e vendimeve në kushtet e konfliktit të interesit; Është bashkëpunuar për ndarjen e detyrave, sipas kompetencave midis të zgjedhurve dhe të emëruarve, kjo në rastet e paqartësive; U janë kaluar për shqyrtim e vlerësim kërkesat dhe ankesat e qytetarë dhe subjekteve të ndryshme, brenda kompetencës tyre, pavarësisht institucionit që i është drejtuar.

Janë organizuar takime të shumta për: Zhvillimin e territorit; Menaxhimin e mbetjeve; Mbarëvajtjen e sezonit turistik; Situatën e rendit dhe qetësisë publike; Përballimin e situatave emergjente; Çështjet e luftës kundër trafikimit të personave; Parandalimin, goditjen dhe shkatërrimin e kultivimit të kanabisit; Çështjet e garantimit të sigurisë ushqimore; Përmirësimi i shërbimit shëndetësor, të furnizimit me energji elektrike e ujë të pijshëm; Krijimi i kushteve për zhvillimin normal të procesit mësimor, përfshirë sigurimin e ngrohjes në shkolla dhe sigurinë në shkolla; etj.

## **VI. FUNKSIONET E DELEGUARA, KRYERJA E VEPRIMTARISË NGA INSTITUCIONET TË CILAVE U JANË DELEGUAR FUNKSIONET NGA INSTITUCIONET QENDRORE**

### **VI.1. Shërbimet sociale**

Nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, sipas planit të kontrollit të NE dhe PAK, janë kryer 26 kontrolle në njësitë administrative të bashkive. Nga kontrollet e verifikimet e ushtruara ka rezultuar një dëm ekonomik (Mungesë dokumentacioni në dosjet e përfituesve të NE, PAK dhe invalid pune; Mosrespektim i afatit të penalizmit; Mos çekin i personave përfitues të PAK/nvaliditet, trajtim në IEVP; Mënyra e administrimit të dokumentacionit të NE dhe Pak, nga zyrat e financës në bashki- Listpagesat e nënshkuara mbahen në bashki, duke krijuar vështirësi në kontroll, Hartimi i U.Shpenzimeve të përbashkëta për bashkinë Malësi e Madhe, Fushë Arrëz dhe Vau i Dejës, Mungesa e akt marrëveshjeve me Postën Shqiptare, apo bankat e nivelit të dytë, për menyrën e levrimit të fondeve, kjo për bashkinë Pukë, Fushë Arrëz, Vau i Dejës dhe Malësi e Madhe. Kryerja e vizitave në familje jo në përputhje me ligjin dhe mos hedhja në sistem, për reflektimin e ndryshimeve të konstatuara, 36 persona)

Si rezultat i masave të marra nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, nepermjet inspektimeve të ushtruara në njësitë të vetëqeverisjes vendore dhe verifikimeve në familje, për numrin e rasteve të trajtuara në shkelje të ligjit, ka një administrim dhe mirë menaxhim të fondeve të buxhetit për shtresat në nevojë

Janë shqyrtuar, duke kthyer përgjigje 17 kërkesë/ankesa të ardhura nga qytetar, nepermjet platformës së bashkëqeverisjes, SHSSH, avokatit të popullit dhe MShMS. Janë pritur në zyrë, duke i sqaruar në lidhje me shërbimet sociale 937 persona.

Me mbështetje e donatorëve të ndryshëm janë shpërndarë 710 pako ushqimore familje në nevojë, 632 kuti me ndihma materiale, 142 paisje ndihmese për persona në PAK jane pajisur me artikuj shkollor, 100 fëmijë të familjeve në nevojë;

Në kryerjen e veprimtarisë gjatë vitit është bashkëpunuar me subjekte publike e jo

publike; Njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas marrveshjeve të bashkëpunimit; DR të AKPA; QOFPP; DRAP Lezhë; IShPSHSH; Shoqatën “The Door”, Qendren YEA, YËCA of Albania, “Motrat e Nënë Terezës”, “Projekti Shpresa”, Caritas Dioqezan, “Madonina del Grappa”, “Komunitetit Papa Xhovani XXIII”, “Vëllezrit e Nënë Terezës” e Shoqata të tjera, të cilat zhvillojnë aktivitetet e tyre në qark

## **VI.2. Zhvillimi i territorit**

Për zhvillimin e territorit nga ana e Insitucionit të Prefektit janë ndjekur problem te ndryshme të territorit si strehimi, pronësie dhe mjedisi. Jane ndjekur dhe mbikqyrur nismat për të gjitha hapat e caktuara per zbatimin e planeve të përgjithshme vendore për bashkitë e qarkut shkodër, duke rekomanduar bashkërendimin e punës në të gjitha hapat për një zbatim sa më me eficencë të këtyre planeve. konformë ligjit Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e teritorit”, duke ndjekur problemet në lidhje me distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës dhe lartësinë e ndërtesës, zbatimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve të paligjshme nga ana e Inspektoriatit vendor të mbrojtjes së territorit, shqyrtimi i ndërtimeve pa leje, shtesat anësore dhe në lartësi, dhe poblemeve me ndotjen e mjedistit nga lëndët djegëse nga aktiviteteteve tregtare. Kemi marrë pjesë aktive në të gjitha seminarët dhe takimet e organizuara nga GIZ dhe Agjencia Kombetare per Menaxhimin e Burimeve Ujore, lidhur me sigurine dhe mbrojtjen nga permbytja. Ndërsa nga muaji Dhjetor ka filluar projekti për shpalljen e Pellgut Ujëmbledhës të Liqenit të Shkodrës një zonë UNESCO në kategorinë "Rezervë Biosfere Ndërkufitare"Në zbatim të ligjit 111/2012 dt. 15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar; VKM-së Nr.550 datë 15.07.2020 “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me konçesion të përdorimit të burimit ujqor, e lejes/autorizimit për përdorim të burimit ujqor...”, si dhe në vendimet e K.K.U-së nr. 06 datë 12.06.2019 “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Basenit Ujqor”, është bashkëpunuar me Zyrën e Administrimit të Besenit Ujqor Drin-Bunë për të gjitha problemet që janë paraqitur duke bërë verifikimin e problemeve sipas rasteve të paraqitura dhe përgatitjen e marrjen e masave per organizimin e 5 mbledhjeve të KBU, të drejtuara nga Prefekti i Qarkut ku janë trajtuar problematika të ndryshme për burimet ujqore dhe janë miratuar 22 propozime, nga të cilat: 6 miratime për subjektet që përdorin ujin për prodhim energjie, 1 miratim që përdorin ujin për proces teknologjik, 2 miratime për subjektet që përdorin ujin për akuakulturë, 2 miratime per subjekte që kanë veprimtari në brigje, 2 raste transferim leje, dy raste ndryshime sisteme kordinatash, dy raste shfuqizime leje perdorimi ujqor, ndersa 5 raste të ndryshme.

Me Urdhër të Prefektit Nr. 53, datë 10.07.2023, është ngritur grupi ndërinstitucional i punës me drejtuesit e përfaqësues të Institucioneve qendrore në nivel vendor dhe njësisive të vetëqeverisjes vendore, për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit, grup i cili ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e plan veprimit “Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2023” Në zbatim të urdhërit të mësipërm janë organizuar disa takime me Istitucionet kryesore përgjegjëse për mbarëvajtjen e sezonit turistik, po ashtu janë bërë dhe monitorime në terren .Gjatë monitorimit në terren, në vijim të masave të marra për kontrollin e vijës bregdetare në Velipoje, u konstatua heqja e bovave, litarëve dhe tapave të përdorura për krijimin e 4 korridoreve hyrëse dhe dalje, të paligjshme, për mjetet lundruese në hapësirën ujore. Heqja e mjeteve të përdorura u krye në bashkëpunim me Policinë Bashkiake Shkodër, Agjensinë Rajonale të Bregdetit dhe me mbështetjen e Drejtorisë së Policisë Kufitare Shkodër.U monitorua ne vazhdimësi zbatimi i kushteve dhe kriterëve mbi sigurinë në plazhe nga subjektet e licensuara për ushtrimin e aktivitetit në stacionet e plazhit, rrespektimi i hapësirave publike, prezenca e vrojtuesëve të plazhit si dhe sinjalistika përkatëse.Po ashtu, u trajtuan vështiresi të hasura mbi pajisjen e të gjithë vijës bregdetare me sinjalistikën kufizuese; higjienën dhe pastertinë; ndotjet akustike etj, për të cilat u lënë detyra përkatëse.Një specialist i sektorit tonë ka qenë i angazhuar gjatë gjithë vitit me projektin e financuar nga BE, ”Katasrofat nuk njohin Kufij” ky projekt është zhvilluar në bashkëpunim me Malin e ZI.Po ashtu në vazhdimësi janë trajtuar letërankesa të ndryshme dhe janë kryer detyra me porososi të titullarit.- Kemi qenë pjesë e grupeve të organizuara nga Institucioni për kontrodhin e mbetjeve të hedhura në vende problematike si shtretërit e lumenjve etj.

Me gjithë punën e madhe që po bëhet nga bashkia Shkodër, që vlen për tu pergëzuar Menaxhimi i mbetjeve mbetet akoma problem dhe nje sfide vecanerisht per zonen periferike te qytetit Shkoder e Koplík, perfshi njesite administrative Rrethina, Postribe, Ana e Malit, Guri Zi, Gruemirë, etj. Depozitimi i mbetjeve në vend depozitime të pamiratuara (ose të miratuara nga bashkitë) për bashkinë Malësi e Madhe, Pukë e Fushë Arrëz. Mosmiratimi i venddepozitimit të mbetjeve inerte, duke bërë që depozitimi i tyre në vende të ndryshme dhe kryesisht në brigjet dhe shtretërit e lumenjve të shkaktojë probleme jo vetëm ekologjike, por edhe përmbytje (Hedhja e mbeturinave përgjatë lumit “Kir”) në zonat periferike të qytetit Shkodër dhe fshatrave të Nj.A

Në zbatim të Ligjit nr 81/2017, datë 04.05.2017 “Për Zonat e Mbrojtura”, neni 41, VKM Nr.593, datë 09.10.2018, Pika 1 dhe 2“Për përbërjen, funksionet, detyrat dhe përgjegjësitë e komiteteve të menaxhimit të zonave të mbrojtura mjedisore”.

nga sektori i Zhvillimit Urban është kordinuar puna me ADZM për zhvillimin e mbledhjes së komitetit teknik të zonave të mbrojtura komitet i cili drejtohet nga Prefekti i Qarkut, mbledhja është organizuar date 26. Tetor 2023, në fshatin Lëpushë, Nj. A. Këlmend.

Në takimin e Komitetit të Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura për Parkun Kombëtar “Alpet e Shqipërisë” u theksua rëndësia e pjesëmarrjes së institucioneve qendrore dhe vendore, komunitetit, operatorëve turistike dhe shoqërisë civile për t’i dhënë rëndësinë e duhur dhe kujdesin e veçantë menaxhimit të tij.

Me sfidat e një parku të ri, më i madhi i llojit të tij në Shqipëri dhe me kërkesën gjithnjë e në rritje për zhvillimin e turizmit malor, natyror, kulturor, gastronomik, atij të aventurës, rëndësia e ruajtjes së pasurive natyrore, aseteve kulturore, traditave, zakoneve e dokeve është përgjegjësi

e përbashkët.

### **VI.3. Zhvillimi i turizmit**

Kontributin më të madh në rritjen ekonomike e ka patur sezoni turistik, i cili edhe në qarkun Shkoder, ka qenë i suksesshëm, sukses që ka ardhur falë masave të qeverisë për kryerjen e investimeve publike dhe orfrimin e shërbimeve në destinacioniut turistike

Objektivat e sezonit turistik veror 2023, megjithë problemet e hasura, janë tejkaluar; Kështu gjatë sezonit është:

- Garantuar siguria publike në zonat turistike (Është ruajtur qetësia dhe rendi, janë parandaluar aktet kriminale, duke mos u evidentuar asnjë ngjarje kriminale; Është mirëmenaxhuar trafiku, duke garantuar sigurinë rrugore; Si rezultat i kontroleve dhe masave të marra ka patur një menaxhim të mirë të mjeteve ujore, duke mos shënuar asnjë problem; Janë marrë masa parandaluese ndaj zhurmave, duke eliminuar ndotjen akustike dhe duke krijuar qetësi tek pushuesit; Ka patur një menaxhim më të mirë dhe përpunim të shpejtë të turistëve dhe mjeteve në Pikat e Kalimit Kufitar)

- Rritur numri i turistëve vendas dhe të huaj të cilët kanë vizituar dhe qëndruar si turist, sipas destinacioneve turistike në qark, për rrjedhojë janë rritur të ardhurat nga turizmi. Është rritur numri i subjekteve (të regjistruar në organet tatimore) që ushtrojnë veprimtari biznesi dhe numri i të punësuarve.

Arritjet në zhvillimin e turizmit kanë ardhur nga përmirësimi i nivelit të bashkëpunimit dhe i veprimtarisë së institucioneve qendrore në nivel vendor (duke veçuar bashkëpunimin dhe mbështetjen e strukturave të policisë vendore) dhe njësisve të vetëqeverisjes vendore, për kryerjen e detyrave dhe ushtrimin e përgjegjësive për këtë sektor;

- Është përmirësuar shërbimi shëndetësor, duke plotësuar jo vetëm në numër qendrat shëndetësore me personelin e duhur, por duke qëndruar në gatishmëri e plotësuar të gjitha nevojat në zonat turistike;

- Është përmirësuar infrastruktura rrugore drejt zonave turistike, përfshi edhe vendosjen e sinjalistikës

- Nga ana e bashkisë Shkodër janë kryer investime, për rikonstruksion të rrugëve drejt plazhit Velipojë (Nr. 6, 7) dhe i rrugës Vilu plazh Rrjoll

- Nga ana e ARRSH janë kryer ndërhyrje për rikonstruksione të pjesshme dhe mirëmbajtja e akseve rrugore me destinacion turizmin;

- Nga ana e policisë kufitare janë marrë të gjitha masat për të ofruar një shërbim të shpejtë në lëvizjen e shtetasve të huaj e shqiptar (hyrje e dalje) në pikat e kalimit kufitar (Muriqan, Hani i Hotit, Grabom dhe Vermosh) si dhe për përdorimin e mjeteve motorike lundruese argëtuese (Si rezultat i masave të marra nga shërbimet e policisë kufitare, në stacionet e plazhit, nuk ka patur asnjë incident nga mjetet lundruese argëtuese gjatë sezonit turistik;

- Nga ana e Autoritetit Kombëtar të ushqimit janë kryer inspektime dhe kontrole, lidhur me zbatimin e detyrimeve ligjore, në plotësimin e kushteve dhe standardeve ushqimore, si dhe mbrojtjes së konsumatorit;

- Nga ana e organeve tatimore janë marrë masa kundër informalitetit, goditjen e paligjshmërisë dhe evazionit fiskal, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së biznesit nga subjektet private në zonat turistike.

- Nga ana e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes energjisë elektrike dhe Sh.A Ujësjiellës-Kanalizime, nëpërmjet masave të marra është siguruar furnizim pa ndërprerje me energji elektrike dhe ujë të pijshëm gjatë gjithë sezonit;

Nga ana e Prefektit të qarkut, në cilësinë edhe të drejtuesit të KRZHT;

- Është ngritur Komiteti Rajonal i Zhvillimit të Turizmit, mbështetur në pikën 1 të nenit 20 të Ligjit Nr. 93/2015, datë 27.07.2015 “Për Turizmin” dhe Udhëzimin Nr. 8502 datë 24.10.2016 të Ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit” (pika 2.1, 2.2, 2.3 e kap. II), komiteti i cili drejtohet nga Prefekti dhe ka në përbërje përfaqësuesit e institucioneve dhe njësitë të vetëqeverisjes vendore

- Është hartuar e miratuar plani i veprimit në nivel qarku “Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2023” duke u mbështetur në planet e Institucioneve qendrore në nivel vendor dhe njësitë të vetëqeverisjes vendore, përgjegjëse për zhvillimin e veprimtarisë turistike

- Janë organizuar takimet e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit, në të cilën janë ftuar edhe të gjithë drejtuesit e Institucioneve dhe njësitë të vetëqeverisjes vendore, takime në të cilat është analizuar e vlerësuar veprimtaria e Komitetit dhe Institucioneve dhe njësitë të vetëqeverisjes vendore, masat e marra, problemet e hasura

- Është bërë hapja zyrtare e sezonit turistik (Në bashkinë Shkodër, në plazh Velipojë, pikën turistike të Thethit e Shirokës, si dhe në Nj. A. për promovimin e vlerave dhe resurseve, kryesisht në fushën e agroturizmit, të cilat ndikojnë në zhvillimin social ekonomik të këtyre njësitë; Në bashkinë Malësi e Madhe në pikën turistike Razëm e Vermosh; Në bashkinë Vau i Dejës në Nj. A Vau i Dejës e Temal, në promovimin e vlerave në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm të turizmit; Në bashkinë Pukë)

- Është publikuar kalendari i festave lokale dhe ngjarjeve të tjera të rëndësishme të qarkut, sipas njësitë të vetëqeverisjes vendore

- Është ngritur grupi ndërinstitucional i punës me drejtuesit e përfaqësues të Institucioneve qendrore në nivel vendor dhe njësitë të vetëqeverisjes vendore, për monitorimin e zbatimit të planit të veprimit (Urdhër i Prefektit Nr. 53, datë 10.07.2023), grupi i cili ka monitoruar në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e plan veprimit “Për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik veror 2023”

- Janë ngritur strukturat menaxhuese të dedikuara për sektorin e turizmit.

- Në funksion të menaxhimit dhe mbarëvajtjes së sezonit turistik veror, zhvillimit të këtij sektori me peshë të konsiderueshme në rritjen ekonomike, janë organizuar takime të herëpashershme me drejtuesit e institucioneve qendrore në nivel vendor dhe të njësitë të vetëqeverisjes vendore dhe për raste të konstatimit të problemeve, takime me drejtues të atyre institucioneve në të cilat janë shfaqur, për zgjidhjen e tyre

- Është koordinuar nga Prefekti, veprimtaria e Bashkive, Institucioneve Shtetërore Rajonale, Agjencive dhe Inspektorateve për zbatimin e plan veprimit dhe detyrimeve ligjore, sipas fushave dhe përgjegjësitë, për mbarëvajtjen e sezonit turistik;

- Kanë funksionuar zyrat e informacionit turistik në Shkodër, Velipojë e Theth, duke i shërbyer si vizitorëve, ashtu edhe marketingut të destinacioneve turistike.

- Është bërë promovimi i destinacioneve, ofertave turistike nëpërmjet organizimit të panairëve dhe aktiviteteve të ndryshme kulturore dhe të traditës, sipas bashkive dhe njësitë

administrative të këtyre bashkive

***Gjatë sezonit;***

Nga pikat kufitare gjatë sezonit turistik kanë hyrë dhe dale (janë përpunuar në PKK) gjithsej 2,807,993 shtetas dhe 953,593 mjete, ose 604,976 shtetas dhe 171,322 mjete më shumë krahasuar me sezonin e vitit të kaluar 2022

- Është rritur numri i pushuesve të akomoduar në strukturat akomoduese- Resort, Hotel, Motel, Bujtinë, etj., për rrjedhojë edhe të ardhurat nga taksa e fjetjes në hotel krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Janë arkëtuar të ardhura nga taksa e fjetjes në hotel me vlerë rreth 9.414.206 lekë lekë

- Është rritur mbi 20 %, numri i turistëve të huaj, të cilët kanë vizituar Zonat e Mbrojtura, krahasuar me vitin e kaluar

- Numri i turistëve, të cilët vizituan kalanë “Rozafa” ka qenë rreth 77,680

- Është rritur numri i vizitorëve të cilët kanë vizituar muzetë e qytetit Shkodër, përfshi edhe Muzeun Kombëtar të Fotografisë “Marubi”

Nga ana e Autoritetit Kombëtar të ushqimit janë kryer 243 inspektime e kontrole në terren (restorante, fastfoode, furra buke) në zonat turistike, si dhe nga laboratorit për 38 mostra. Për parregullsitë dhe shkeljet e konstatuara (Tregtim në kushte të pa pershtatshme higjieno-sanitare; Mungesë e sistemit të gjurmueshmërisë së ushqimeve) janë marrë 58 masa administrative “Paralajmërim, për ndërprerje të aktivitetit”.

Nga ana e organeve tatimore, sipas planit operacional të punës, janë marrë masa, për goditjen e paligjshmërisë dhe evazionit fiskal, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së biznesit nga subjektet private në zonat turistike;

Nga ana e Degës Rajonale të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor janë kryer 474 inspektimet (386 Inspektim lidhur me zbatimin e kushteve higjieno-sanitare, 148 inspektime mbi parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve infektive dhe 96 inspektime në Q.Sh për ploësimin e kushteve të shërbimit) dhe 50 riinspektime; monitorime, për zbatimin e ligjit “Për mbrojtjen e Shëndetit nga Produktet e duhanit” dhe “Për mbrojtjen e të miturve nga përdorimi i alkoolit”; Në përfundim të të cilave për parregullsitë dhe shkeljet e vërtetuara, janë marrë 3 masa administrative (Gjobë)

**Problemet e hasura gjatë sezonit, të cilat kanë ndikuar dhe ndikojnë në barëvajtjen, menaxhimin dhe zhvillimin e turizmit:**

- Gjëndja jo e mirë e infrastrukturës rrugore në segmentin Qafa Laç-Koman
- Problemet e pronësisë mbi pasurinë në menyrë të veçantë në zonën turistike Theth
- Menaxhimi i mbetjeve, ndotja e liqenit të HEC Koman (e cila krijohet nga grumbullimi i mbetjeve të lumenjve dhe nga mjetet e transportit ujor, të cilat ushtrojnë

veprimtarinë e transportit në këtë liqen); Frekuenca e largimit të mbetjeve nga kontenjerët, frekuencë e cila nuk i përgjigjet nevojave të kerkuara në zonat e mbrojtura (Pikën turistike Theth) dhe afërsi të Kalasë “Rozafa” (vendparkimi i autobuzëve të turistëve) dhe në destinacione të tjera turistike, përfshi qytetin Shkodër; Si dhe mungesa e kontenjerëve/kazanëve të grumbullimit të mbetjeve në pjesë të territorit të ZM.

- Mungesa e shërbimit të transportit publik drejt dhe në pikën turistike Theth, problematikë edhe e sezoneve të kaluara për lëvizjen e turistëve të huaj dhe jo vetëm

- Ushtrimi i veprimtarisë nga agjenci me guida turistike të palicensuara

- Mos zbatimi i kriterëve dhe standardeve të përcaktuara në rregulloren “*Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit plazhit*” (miratuar në VKM 171, datë 27.03.2019, me ndryshime), në stacionet e plazhit

- Lidhja me vonesë e kontratave për përdorimin e hapësirës publike nga ana e njësisve vendore me subjektet që do të ushtrorjnë veprimtarinë e stacionit të plazhit.

- Mungesa e rojeve bregdetare (vrojtuesve të çertifikuar) dhe shërbimit të vrojtimit, mungesë që sjell probleme në kryerjen e shërbimit në të gjithë zonën e plazhit, me rrisht të sigurisë e pushuesve; Si dhe mungesa e kryerjes së shërbimit të vrojtimit (mungesa e vrojtuesve) në kohë dhe orë me numër të reduktuar pushuesish dhe jo gjatë gjithë kohës kur stacioni i plazhit është i hapur

- Përcaktimi i zonës së notimit, konturimi me bova në një distancë 200 m

- Mungesa e shënjave notuese në koridoret e lëvizjes së mjeteve lundruese argëtuese, Mospërcaktimi dhe mosmiratimi i vendbazimeve të mjeteve lundruese argëtuese; Mungesa e pikave të ankorimit për mjetet lundruese, si dhe disiplinimi i lundrimit të mjeteve lundruese

- Ofrimi i standardeve në plazhet publike, veçanërisht pjesa e kriterëve të lidhura me sigurinë në plazhe dhe infrastruktura e plazhit publik (Tabelizimi i të gjitha hapsirave publike, Ngritja e pikave të vrojtimit dhe pajisja e hapsirave publike me vrojtues të çertifikuar; Sigurimi i pastrimit të hapsirave publike; Pajisja e hapsirave publike me shërbime higjienike; Markimi i zonës së notimit)

- Prezenca e shitësve ambulant në hapësirat në mes vijës ujore e stacioneve të plazhit

## REKOMANDIME

- Rishikimi i Rregullores “*Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit*” (miratuar me VKM Nr. 171, me ndryshime), për;

- Garantimin e sigurisë së pushuesve në stacionet e plazhit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratave (për të shpëtuar jetën në ujë dhe për të dhënë ndihmën e pare mjekësore) dhe shmangien e formalizmave (rishikimin e neni 5/8/b tërregullores), duke i ngarkuar kontraktimin e shërbimit të vrojtimit për të gjithë territorin e plazhit, autoritetit shtetëror (Institucioni qendror/njesisë së vetëqeverisjes vendore) kundrejt një tarife, të qiramarrësit të hapësirës publike për ushtrimin e aktivitetit të stacionit të plazhit (sipas sip. së çdo stacioni)

- Monitorimi dhe ndërhyrjet, për paligjshmërinë e veprimeve të kryera nga persona/subjekte, në zonën bregdetare, të përfundojnë përpara fillimit të sezonit turistik veror 2023, kjo për të shmangur ndërhyrjet gjatë sezonit me ndikim negativ në zhvillimin e turizmit

- Ofrimi i shërbimit të transportit publik drejt dhe në pikën turistike Theth (Licensimin e subjekteve, nënshkrimin e marrëveshjeve për kryerjen e shërbimit, caktimi i stacioneve të nisje-mbërritjeve dhe kontaktet e tyre në vende të dukshme me tabela fizike dhe aksesueshëm në internet-faqet Eëb të Bashkisë Shkodër; AdZM Shkodër; Si dhe pranë zyrave të informacionit turistik etj.);

- Bashkëpunimi njësi e vetëqeverisjes vendore me institucionet qendrore në marrjen e masave për zgjidhjen e problemit të pronësisë mbi pasurinë në zonat turistike, në menyrë të veçantë në zonën turistike Theth, mbi ndikim në zhvillimin e turizmit dhe jo vetëm

- Marrja e masave për rikonstrukcionin e segmentit rrugor “Qafa Laç-Koman”, segment me një fluks të lartë lëvizjesh të vizitorëve/turistëve vendas dhe të huaj drejt destinacioneve turistike, jo vetëm brenda territorit të qarkut (bashkëpunimi ndërinstytucional për krijimin e burimeve financiare për mbulimin e shpenzimeve të rikonstrukcionit të rrugës)

#### **VI.4. Shërbimi i gjendjes civile**

Zyra e Arkivit të Gjendjes Civile ka grumbulluar, administruar dhe kontrolluar aktet e gjendjes civile (lindje, martesë, vdekje) të mbajtura nga zyrat e gjendjes civile të bashkive dhe NjA pjesë përbërëse e bashkive, mbështetur në Ligjin Nr. 10129, dt 11.05.2009 “Për gjendjen Civile”, me ndryshime (neni 32 “Administrimi dokumentacionit”), për cilat është dokumentuar dorëzimi (me procesverbal), duke dhe kryer lidhjet e këtyre akteve.

Janë lëshuar çertifikata përkatëse (sipas kërkesave të shtetasve apo institucioneve të ndryshme), të gjendjes civile, për dokumentacionin që administrojnë vetë zyra, duke u bazuar në rregjistrat themeltarë si dhe në aktet e tjera

Është ndjekur zbatimi i vendimeve të marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, bazuar në Ligjin “Për Gjendjen Civile” dhe Udhëzimin Nr.481, dt 05.09.2013 “Për procedurat e korrigjimit të emrit/mbiemrit si gabim material”, nga zyrat e Gjendjes Civile të bashkive dhe njësive administrative pjesë përbërëse e këtyre bashkive, duke bërë verifikimet në Rregjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

U është kthyer përgjigje, me informacionin e kërkuar, brenda afatit, kërkesave të Institucioneve të ndryshme

Është bashkëpunuar me zyrat e Gjendjes Civile të njësive të vetëqeverisjes vendore për marrjen e masave në shqyrtimin e kërkesave, për gabimet në regjistra dhe korrigjimin e tyre

U janë bërë të njohura zyrave të gjendjes civile brenda qarkut, ndryshimet e akteve ligjore e nënligjore”Për gjendjen Civile”



## VII. ORGANIZIMI DHE VEPRIMTARIA E ADMINISTRATËS

### VII.1. Organizimi dhe shpenzimet e kryera për zhvillimin e veprimtarisë

Administrata e Prefektit është e organizuar dhe funksionon, sipas strukturës së miratuar nga Kryeministri (Urdhër Nr. 11 dt. 12.01.2016 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Shkodër"), me një organikë prej 27 punonjësish:

1.	Prefekt	1
1.1	Sekretar i Prefektit	1
2.	Sekretari i përgjithshëm	1
3.	Nënprefekt (Malësi e Madhe dhe Pukë)	2
4.	Spektori i monitorimit të kompetencave vendore dhe funksioneve të deleguara	6
5.	Spektori i zhvillimit urban	3
6.	Spektori i planifikimit, përballimit të emergjencave civile dhe krizave	3
7.	Spektori juridik	3
8.	Spektori i financës dhe shërbimeve mbështetëse	7

Në fakt 6-mujorin e dytë të vitit 2023, administrata ka funksionuar me 1 punonjës më pak (mungon specialisti në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse), pasi pozicioni i punës ka mbetur vakant, për arsye të moskryerjes së procedurave të konkurrimit dhe emërimit në këtë pozicion. Në këto momente ky pozicion është në fazën e fundit të emërimit. Po ashtu kemi vakant edhe pozicionin e përgjegjësit të sektorit të monitorimit dhe delegimit të kompetencave vendore.

Të punësuar nga programi i ekselencës 2 punonjës të rinj, përkatësisht: 1 punonjës në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe 1 punonjës në Sektorin e Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara.

Për zhvillimin e veprimtarisë, nga ana e Institucionit, janë kryer shpenzime me vlerë 41,713. 655 mijë lekë, ose 90 % e shpenzimeve të programuara për gjithë vitin buxhetor. Ndërsa nga zyra e gjendjes civile janë kryer shpenzime me vlerë 3,765. 368 mijë lekë, ose 97 % e shpenzimeve të programuara për gjithë vitin buxhetor.

Programimi dhe përdorimi i fondeve, sipas programeve, në nivel art. Paraqitet si më poshtë:

			në leke
<b>Totali I shpenzimeve per 2 programet: Prefektura dhe Gjendja civile</b>	<b>41,713,655</b>	<b>3,765,368</b>	

**Min 16, Programi :01160, kap 1**

në lek

Artikujt	Emertimi	Prefektura Shkoder	Prefektura Shkoder
		plani 2023	fakti 2023
600	Paga, shperblime dhe te tjera shp personeli	29,290,000	28,166,894
601	Kontribute per Sig Shoqerore dhe Shendetesore	4,853,000	4,672,800
602	Mallra dhe sherbime te tjera	7,500,000	5,023,674
602.0	Materiale dhe sherbime zyre dhe të përgjithshme	580,000	564,280
602.1	Materiale dhe sherbime speciale	320,000	268,720
602.2	Shërbime nga të tretet	2,550,000	2,151,786
602.3	Shpenz. transporti	560,000	326,820
602.4	Shpenz. udhetimi	250,000	194,970
602.5	Shpenz. per mirembajtje te zakonshme	1,430,000	1,197,860
602.7	Shpenz. per detyrime dhe kompesime te tjera legale	1,370,000	0
602.9	Shpenz. te tjera operative	440,000	319,238
606	Transferta për Buxhete Familjare dhe Individe	200,000	194,200
231	Projekti Katastrofat nuk njohin kufij kap 2	400,000	
231	Projekti Katastrofat nuk njohin kufij kap 3 kosto lokale	1,699,246	1,699,246
231	Projekti Katastrofat nuk njohin kufij kap 4 tvsh	2,404,578	1,956,841
	<b>Totali</b>	<b>46,346,824</b>	<b>41,713,655</b>

**Min 16, Programi :01170, kap 1**

në lek

Artikujt	Emertimi	Gjendja Civile plani viti 2023	Gjendja Civile fakti 2023
600	Paga, shperblime dhe te tjera shp personeli	3,210,000	3,148,619
601	Kontribute per Sig Shoqerore dhe Shendetesore	551,900	515,949
602	Mallra dhe sherbime te tjera	21,000	0
606	Transferta për Buxhete Familjare dhe Individe	100,800	100,800
	<b>Totali</b>	<b>3,883,700</b>	<b>3,765,368</b>

**VII.2. Urdhërat e nxjerra dhe zbatimi i tyre**

Për bashkërendimin e veprimtarive të institucioneve qendrore në nivel vendor dhe me njësitë e vetëqeverisje vendore dhe realizimin e detyrave nga administrata e Institucionit nga

Prefekti janë nxjerrë 120 Urdhra, me problematika të ndyshme, të cilat janë zbatuar, sipas afateve të përcaktuara

Administrata ka zbatuar në të gjitha rastet urdhërat e nxjerrë, duke siguruar në këtë mënyrë efektivitetin e tyre.

### **VII.3. Takimet e organizuara në funksion të kryerjes së veprimtarisë**

#### **Veprimtaria e organit këshillues të prefektit të qarkut në zbatim të nenit 23 të ligjit nr.107/2016 “Për prefektin e qarkut”**

Në funksion të kryerjes veprimtarisë dhe ushtrimit të përgjegjësive nga ana e prefektit janë zhvilluar rreth 60 takime të cilat në formë të përmbledhur, sipas çështjeve të trajtuara, paraqiten:

- Analizat e veprimtarisë vjetore 2022 dhe 6/mujore 2023 të Institucionit, si dhe pjesëmarrje në analizat vjetore të veprimtarisë së institucioneve vendore

- Mbi problematikën në kuadër të luftës kundër kultivimit të bimëve narkotike, Zbatimi i Planit Kombëtar të veprimit antikanabis për Qarkun Shkoder (Takime periodike të Prefektit me drejtues të njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve vendore si dhe takime sensibilizuese në njësitë e vetëqeverisjes vendore)

- Mbi çështjet e luftës kundër trafikimit të personave ( Takime, përfshi takimet periodike të Komitetit Rajonal të luftës kundër trafikimit të Personave dhe të Tryezës Teknike), takime të cilat janë organizuar në bashkëpunim me MB (Zyrën e Koordinatorit Kombëtar)

- Mbi masat për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik (Takim i Komitetit Rajonal të Turizmit, evidentimi i masave të marra nga të gjithë Institucionet për fillimin, marvajtjen e sezonit turistik dhe zhvillimin e turizmit gjatë vitit 2023, ngritjen e grupit të punës për monitorimin e zbatimit të planit të masave për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik; Takim me drejtues të bashkisë Shkodër në kuadrin e masave për fillimin e sezonit turistik veror; Takim në pikën turistike Theth e Vermosh, lidhur me përgatitjet për fillimin e sezonit turistik; Takime në bashkinë Malësi e Mde, Vau Dejës e Pukë e Fushë Arrëz në çelje të sezonit turistik);

- Takim me drejtues të bashkisë Shkodër dhe të institucioneve vendore (DVP, DVKM, ARSh), lidhur me punën dhe masat e marra për lehtësimin e levizjes së mjeteve të transportit rrugor në akset rrugore drejt destinacioneve turistike, por edhe në qytet (me vëmendje të shtuar qarkullimin drejt dhe në zonën e plazhit Velipojë), me qëllim parandalimin e aksidenteve, garantimin e sigurisë rrugore dhe rendit publik, si dhe mbarëvajtjen dhe zhvillimin e turizmit gjatë vitit 2023 në qarkun Shkodër

- Takime me drejtues të njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve vendore dhe strukturat e KMCQ, lidhur me situatën e krijuar nga reshjet e shiut dhe përmbytjet nga reshjet e dëborës gjatë stinës së dimrit dhe përcaktimin e masave për përballimin e situatës dhe takime të Komisionit të Mbrojtjes Civile të Qarkut, lidhur me masat për parandalimin e rënies së zjarreve, menaxhimin dhe përballimin e situatës së zjarreve gjatë verës dhe reshjet e shiut, përmbytjet dhe reshjet e dëborës

- Mbi shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të përdorimit të burimeve ujore dhe dhënie autorizimi nga Këshilli i Basenit Ujor Drin-Bunë janë organizuar e zhvilluar 5 takime

- Takimi me drejtues të bashkive, të Zyrave Vendore Arsimore Prauniversitare (Shkodër, Malësi e Madhe, Vau i Dejës, Pukë dhe DRAP Lezhë), perfaqësues të Drejtorisë

Vendore të Policisë, të NJVKSH dhe Degës Rajonale të ISHSH; lidhur masat e marra për fillimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor, gjatë vitit shkollor 2023- 2024 dhe paketen e sigurise ne shkolla.

- Takime, në kuadër të implementimit të projektit “*Katastrofat nuk njohin kufinj2*”

- Takim i Komitetit te Zonave te Mbrojtura me drejtues të bashkive, të Drejtorisë Vendore të Policisë, Drejtorisë Rajonale të IKMT, Administratës Zonave të Mbrojtura etj, lidhur me zbatimin e detyrimeve ligjore.

- Takim mbi marrjen e masave per parandalimin e ekstremizmit te dhunshem ne Shqiperi

- Takime periodike të Prefektit me drejtues të Bashkive dhe të Institucioneve Vendore që ushtrojnë veprimtarinë në territorin e bashkisë si dhe drejtues e përfaqësues të institucioneve rajonal lidhur me zbatimin e detyrimeve ligjore sipas fushave të përgjegjësisë e kryerjen e detyrave të përbashkëta për realizimin e programit dhe objektivave të qeverisë, ofrimin dhe rritjen e nivelit të shërbimit ndaj qytetarëve dhe përmirsimin e vazhdueshëm të nivelit të jetesës së tyre

#### **VII.4. Vlerësimi dhe trajtimi i ankesave të shtetasve**

Ushtrimi i përgjegjësisë së Prefektit, për shqyrtimin e ankesave dhe zgjidhjen e konflikteve, është kryer duke zbatuar kërkesat e kodit të procedurave administrative (Ligji Nr.44/2015, datë 30.04.2015)

Gjatë vitit në Institucionin e Prefektit janë shqyrtuar dhe vlerësuar, duke kthyer përgjigje 64 kerkesa dhe ankesa të qytetarëve, të cilat sipas problematikës paraqiten:

- Për çeshtjet e pronësisë dhe zënien e hapësirave publike 14;
- Për mjedisin e menaxhimin e mbetjeve 1;
- Për mbrojtjen civile 4;
- Për strehimin 2;
- Për probleme të transportit dhe punësimit 3;
- Per problemet e ujesjellesit 1;
- Per punesimin 3;
- Per emergjencat civile 3;
- Të tjera 33;

#### **VII.5. Veprimtaria e N/Prefektit**

Në përbërje të administratës së prefektit, mbështetur në nenin 22 të Ligjit 107/2016, datë 27.10.2016 “*Për Prefektin e qarkut*”, kanë zhvilluar veprimtarinë nënprefektët Malësi e Madhe dhe Pukë.

Nënprefekti ka ushtruar detyrat funksionale, përcaktuar në detyrat e administratës së Prefektit (miratuar me Urdhrin Nr. 50, datë 12.04.2017, të Kryeministrit) dhe në Rregulloren Organizative të Brendshme të Institucionit, Kështu;

Ka bashkëpunuar me institucionet qendrore ne nivel vendor, duke kerkuar prej tyre marrjen e masave për realizimin e detyrave, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore qe rregullojnë veprimtarinë e tyre,;

Në kuadër të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të veprimtarive të institucioneve qendrore në nivel vendor, si dhe të ketyre institucioneve me bashkitë, janë organizuar takime gjatë vitit, sipas problemeve të dala; përballimin e situatave të emergjencave të krijuar nga reshjet gjatë periudhës dimrit dhe nga zjarret gjatë periudhës verore; mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, menaxhimin e mbetjeve, etj.

Nga ana e nënprefektit janë marrë masat për zbatimin e urdhrave të nxjerra nga prefekti.

Pranë nënprefektëve kanë funksionuar zyrat e ankesave të qytetarëve dhe subjekteve që ushtrojnë aktivitet brenda territorit të tyre;

Janë konfirmuar çertifikatat e lëshuar nga ana e punjonjësve të gjëndjes civile të bashkive dhe Nj.A pjesë përbërëse e bashkive (Malësi e Madhe; Pukë dhe Fushë Arrëz), si dhe brenda kompetencave ligjore janë lëshuar dokumente të tjerë, sipas kërkesave të qytetarëve;

Për problemet e dala në bashkitë që mbulojnë është raportuar vazhdimisht gjatë vitit tek Prefekti.

## VIII. VEPRIMTARI TË TJERA TË PREFEKTIT

a. Shqyrtimi i masave administrative plotësuese, për kundravajtjet administrative, të leje të drejtimit të shtetasve të huaj

Mbështetur në Ligjin Nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Nr.10279, datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”, si dhe Udhëzimit të Ministrisë Punëve të Brendshme Nr.687, datë 5.12.2013 “Për mënyrën e evidentimit dhe të shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese, administrimi i gjobave dhe pasqyrat statistikore në fushën e qarkullimit rrugor”, i ndryshuar, neni 19, nga ana e Prefektit është shqyrtuar dokumentacioni i sjellë nga Drejtoria Vendore e Policisë në 26 raste, duke marrë vendimet përkatëse

b. Legalizimi i dokumentëve për përdorim jashtë vendit

Mbështetur në aktet ligjore e nënligjore dhe në zbatim të Urdhrit të Prefektit gjatë vitit është bërë legalizimi (vërtetimi) i 5135 dokumentëve (Nga Sektori i Shërbimeve mbështetëse 3140 nga N/Prefekti Malësi e Madhe 1116 dhe N/Prefekti Pukë 879), të lëshuara nga zyrat e gjendjes civile dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore (Çertifikatë, Vertetim), për përdorim jashtë vendit, me një rënie të ndjeshme nga vitet e kaluara qe ka ardhur si rezultat e marrjes së shërbimit online nepermjet portalit e-albania

c. Zbatimi i projektit “Katastrofat nuk njohin kufij2”

Institucioni i Prefektit (grupi i punës i ngarkuara me Urdhër të Prefektit, në përbërje të të cilit ka qenë Sekretari i Përgjithshëm-në cilësinë e Koordinatorit të Projektit; Specialisti i Sektorit të Zhvillimit Urban, i cili ka patur edhe punën më të madhe në zbatimin e projektit; 2 Specialistët e Sektorit të Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara-në cilësinë e financierit dhe juristit të projektit), si institucion përfitues, në kuadrin e projekteve me fondet e BE, gjatë vitit është angazhuar në zbatimin e projektit “Katastrofat nuk njohin kufij 2”

Projekti “Katastrofat nuk njohin kufij 2”, financuar nga Bashkimi Evropian në kuadër të

Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II, Mal Zi – Shqipëri është zbatuar nga institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër në rolin e përfituesit, në partneritet me organizatën FORS Montenegro. Projekti ka patur për qëllim përmirësimin e kapaciteteve logjistike dhe të burimeve njerëzore të institucioneve dhe shërbimeve, veprimtaria e të cilëve mbulon fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore, sikurse zvogëlimin e rrezikut nga katastrofat përmes edukimit dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve, modernizimin e pajisjeve dhe përmirësimin e bashkëpunimit në zonat ku është zbatuar.

Gjatë vitit 2023, sipas kalendarit të aktiviteteve të projektit, Prefekti i Qarkut Shkodër, në bashkëpunim me institucionet në nivel vendor dhe qëndror ka zbatuar një sërë aktivitete duke kontribuar në përmirësimin e sistemeve dhe shërbimeve të mbrojtjes dhe shpëtimit, dhe zvogëlimin e ndikimit nga fatkeqësitë natyrore në Qarkun Shkodër.

Janë zhvilluar aktivitete me karakter ndërgjegjësues në zonat më të prekura dhe të rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore në qark. Gjatë viti 2023, janë organizuar plot 34 seanca me karakter informues dhe ndërgjegjësues mbi reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë natyrore në systemin arsimor 9-vjeçar, duke arritur një numër prej 635 nxënës. Janë organizuar 5 vizita të informuese për 92 nxënës, në shërbimet e kërkim shpëtimit, 1 ushtrim demonstrativ evakuimi në raste zjarri, me pjesëmarrjen e 118 nxënësve, 1 konkurs ndërkufitar vizatimi, me tematike mbi mbrojtjen e mjedisit, nga ku u shpallën fitues 2 nxënës nga Qarku Shkodër, të cilëve ju dhuruan pajisje elektronike të prokuruar në kuadër të projektit (laptop dhe tablet).

## **IX. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2024**

Në kuadrin e reformës së qeverisë në administratën publike, ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i mëtejshëm profesional i punonjësve të administratës, duke qenë faktor i rëndësishëm për të siguruar menaxhim efektiv dhe të suksesshëm të sistemeve të kontrollit të brendshëm, do të jetë nga drejtimet kryesore të punës, për arritjen e objektivave:

1. Realizimi i programit qeverisës në nivel qarku (*Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i veprimtarisë së Degëve Territoriale dhe me njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë së tyre, në realizimin e detyrave dhe*

*objektivave, duke kërkuar transparencë; Përgjegjshmëri; Komunikim dhe informim; Llogaridhënie; Ashpërsim të luftës ndaj fenomenit të korrupsionit)*

2. Përballimi i situatave emergjente të krijuara gjatë gjithë vitit nga kushtet atmosferike, apo nga faktor të tjerë (*Marrja e masave për përballimin e situatave emergjente; Përmirësimi i sistemeve të identifikimit të rrezikut dhe fuqizimi i sistemeve të paralajmërimit të hershëm; Rritja e ndërgjegjësimit dhe njohurive në nivel qarku e më gjërë dhe lehtësimi i shkëmbimit të informacionit mbi zvogëlimin e rrezikut ndaj fatkeqësive dhe të mbrojtjes civile; Fuqizimi i aspekteve të gatishmërisë, shërbimeve emergjente dhe kapaciteteve të rikuperimit; Nxitja e krijimit të mbrojtjes financiare nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të mjaftueshme për përballimin e situatave emergjente)*

3. Parandalimi dhe goditja e individëve dhe grupeve kriminale, i fenomeneve që paraqesin rrezik për jetën dhe pronën, si dhe sigurimi i rendit publik (*Bashkëpunimi dhe koordinimi i veprimtarisë me strukturat e policisë së shtetit, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet e tjera ligjzbatuese)*

4. Përmirësimi i nivelit të shërbimit ndaj qytetarëve, nepermjet ushtrimit të funksioneve brenda kompetencave dhe veprimtarisë (*Bashkëpunimin dhe koordinimi i punës me njësitë e vetëqeverisjes vendore, për ushtrimin e funksioneve të transferuara, si dhe monitorimi i kryerjes së këtyre funksioneve dhe përdorimi i fondeve të dhëna nga qeveria për këtë qëllim)*

5. Pastrimi i territorit të qarkut, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, nga mbetjet dhe krijimi i një mjedisi të pastër (*Bashkëpunimi dhe koordinimi i punës me institucionet në nivel vendor, njësitë e vetëqeverisjes vendore, subjektet private, shoqërinë civile, shoqata mjedisore, etj.*)

6. Garantimi i sigurisë publike dhe pastërtisë në zonat turistike, zhvillimin e turizmit familjar në zonat rurale.

**P R E F E K T I**

Majlinda ANGONI

## **BAZA LIGJORE**

Veprimtaria e Institucionit të Prefektit mbështetet në:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë
- Ligjin Nr.107/2016, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”
- Ligjin Nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i punës”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 9367, date 07.04.2005 “Per parandalimin e konfliktit te interesave ne

*ushtrimin e funksioneve publike”, me ndryshime*

- Ligjin Nr. 119/2014, date 18.09.2014 “*Për të Drejtën e Informimit*”
- Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “*Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”
- Ligjin Nr. 9131, date 08.09.2003 “*Per rregullat e etikes se administrates publike*”
- Ligjin Nr. 9887, date 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”
- Ligjin Nr.9970, datë 24.07.2008 “*Për barazinë gjinore në shoqëri*”
- Ligjin Nr. 9154, date 06.11.2003 “*Per arkivat*”, me ndryshime
- Ligjin Nr 9936 datë 26.06.2008 “*Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*”
- Ligjin Nr. 115, datë 21.11.2021 “*Për buxhetin e vitit 2022*”
- Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, me ndryshime
- Ligjin Nr.9228 datë 29.04.2004 “*Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare*”, me ndryshime
- Ligjin Nr 9920 datë 19.05.2008 “*Për Proçedurat Tatimore në RSh*”, me ndryshime
- Ligjin Nr 9632 datë 30.10.2006 “*Për Sistemin e Taksave Vendore*”, me ndryshime
- Ligjin Nr 162/2020 datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*”
- Ligjin Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “*Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit*”, me ndryshime
- Ligjin Nr.8402 datë 10.09.1998 “*Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 10433, datë 16.06.2011 “*Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë*”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 112/2015, datë 15.10.2015 “*Për inspektimin financiar publik*”
- Ligjin Nr. 9780 datë 16.07.2007 “*Për inspektimin e ndërtimit*”, me ndryshime
- Ligjin Nr.9482, datë 06.02.2006 “*Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje*”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 10 237, datë 18.2.2010, “*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 9355, datë 10.3.2005 “*Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore*”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 9587, datë 20.07.2006 “*Për mbrojtjen e biodiversitetit*”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 10431, datë 09.06.2011 “*Për mbrojtjen e mjedisit*”
- Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 “*Për lejet e mjedisit*”
- Ligjin Nr.10463 datë 22.09.2011 “*Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve*”, me ndryshime
- Ligjin Nr. 57/2020 “*Për Pyjet*”;
- Ligjin Nr.10 120, datë 23.4.2009, “*Për mbrojtjen e fondit të bimëve mjekësore, eterovajore e tanifere natyrore*”;



- Ligjin nr. 5/2016 “Për shpalljen e Moratoriumit në pyje”;
- Ligjin Nr. 45/2019 “Për mbrojtjen Civile”;
- Ligjin Nr. 10129 date 11.05.2009 “Per gjendjen civile”, me ndryshime;
- Ligjin Nr. 8951 datë 10.10.2002 “Për numrin personal të shtetasve”, me ndryshime;
- Ligjin Nr. 8952 datë 10.10.2002 “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqipëtar”, me ndryshime;
- Ligjin Nr. 10273 datë 29.04.2010 “Për dokumentin elektronik”, me ndryshime;
- Ligjin nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”;
- Ligjin Nr. 152/2015, datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”;
- Ligjin Nr. ligjit nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”;
- Ligjin Nr. 9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në R. Sh”, me ndryshime;
- Ligjin Nr. 7643, datë 02.12.1992 “Për inspektimin sanitar”, me ndryshime;
- Aktet nënligjore të dala, në dhe për zbatimin e ligjeve;
- Rregulloren organizative të brendshme të administratës së Institucionit